SHKOLLA FILLORE KOMUNALE “IBE PALIKUQA” - BOJANË



# RAPORT PËR VETËEVALUIMIN E SHKOLLËS

# 2022/2023-2023/2024

SHTATOR 2024

# PËRMBAJTJA


| | |
|---|---|
| Komisioni shkollor për vetëevaluimin | 3 |
| Letërnjoftimi i shkollës | 4 |
| Misioni dhe vizioni | 9 |
| Hyrje | 10 |
| Përshkrim i sferave,indikatorëve,temave dhe niveleve | 11 |
| Raport për vetëevaluimin e shkollës | 15 |
| Sfera 1.Planifikim,mësim dhe nxënie | 15 |
| Sfera 2.Arritjet e nxënësve | 36 |
| Sfera 3.Klima shkollore | 47 |
| Sfera 4.Menaxhimi,udhëheqja dhe hartimi i politikave | 71 |
| Përfundim | 82 |

Komisioni shkollor për vetëevaluimin e shkollës 2022/23-2023/24

1.Ejup Poliku – Pedagog

2.Ilirjana Murtezani – Psikolog

3.Bekim Mamuti – arsimtar klasor

4.Zejnie Jakup – arsimtar lëndor

5.Azem Zendeli – prind

SHFK IBE PALIKUQA - BOJANË

Letërnjoftimi i shkollës

Shkolla fillore komunale “ IBE PALIKUQA “është e vendosur në fshatin Bojanë. Fshati Bojanë shtrihet në Veri-perendim të shkupit në largësi prej 23,4 km në rrugën Shkup –Tetovë.Në këtë mjedis me perspektivë, arsimi zhvillohet vetëm në kuadër të shkollës fillore komunale “ IBE PALIKUQA “ në fshatin Bojanë dhe dy shkollat periferike në fshatin Llaskarcë dhe Paniçarë. Këto tre shkolla janë të themeluara në vitin 1945, si shkolla fillore katërvjeçare,prej vitit 1967 në Bojanë hapet shkolla tetëvjeçre, në vitin 1970 edhe shkolla periferike e Llaskarc dhe Paniçarë shëndërohen në tetëvjeçare. Që prej themelimit të tyre e deri më sot, një periudhë si të veçanta e mandej edhe të integruara në një shkollë qendrore, këto objekte edukativo-arsimore në çdo aspekt kanë shënuar një zhvillim permanent në edukimin dhe arsimimin e brezit të ri. Krahas rritjes së numrit të nxënësve,si rezultat edhe i rritjes së numrit të popullatës, janë zgjeruar edhe lokalet e shkollave.Shkolla fillore në Bojanë,Saraj-Shkup, është ndërtuar në vitin 1935, me material të dobët, në vitin 1967 janë ndërtuar tre klasë të reja. Shkolla disponon me nëntë klasë të cilat disa nuk i plotësojnë normat pedagogjike për zhvillimin e procesit edukativo-arsimorë, kjo shkollë ka pesë zyra për personelin e shkollës drejtor, pedagog/psikolog,bibliotek dhe sekretar-arkatar.Shkolla qendrore së bashku me ato periferike disponon me një sipërfaqe shfrytëzuese prej afro 1032 $m^2$, në formë të lokaleve.
Të theksojmë se në fshatin Bojanë mësimi prej klasës së parë deri në klasën e nëntë është zhvilluar dhe zhvillohet në gjuhën shqipe, po ashtu edhe shkollat periferike Llaskarcë dhe Paniçarë mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Në fshatin Paniçarë mësimi mbahet në klasë të kombinuara I-II-IV, III-V, VI-VII, VIII-IX.. Prej themelimit shkolla ka këtë emër, kanë dalë mjaft gjenerata të suksesshme nxënësish të cilët për rezultatet e arritura janë shpërblyer nëpër shumë gara në nivel komunal, të qytetit të Shkupit, Republikan dhe më gjërë.

Të dhënat e përgjithshme të shkollave

| | |
|---|---|
| Emri i shkollës | Shkolla F.K " " IBE PALIKUQA "" - f. Bojanë |
| Adresa, komuna, vendi | f. Bojanë – Komuna Saraj – Shkup |
| Telefoni mob | 072219440 |
| Fax | 2051 – 054 |
| e-mail | ibe.palikuqa@gmail.com<br>ou-ibepalikuqa-bojane-saraj@schools.mk |
| Themeluar prej | Komuna IDADIJA 1965 |
| Verifikimi – Numri i aktit | 11-587/16 – 31.01.1986 |
| Viti i verifikimit | 20 / 1986 |
| Gjuha në të cilën zhvillohet mësimi | Gjuhë shqipe |
| Viti i ndërtimit | 1935 |
| Sipërfaqja e objektit | 1125 $m^2$ |
| Sipërfaqja e oborrit shkollor | 920 $m^2$ |
| Sipërfaqja e terenit sportiv | 720 $m^2$ |
| Shkolla punon në ndërime | Dy ndërime |
| Mënyra e nxemjes së shkollës | Me naftë |
| Numri i klasave | 9 |
| Numri i paraleleve | 18 |
| Numri i ndërimeve | 2 |

| | |
|---|---|
| Emri i shkollës | Shkolla F.K " " IBE PALIKUQA "" - f. Llaskarcë |
| Adresa, komuna, vendi | f. – Llaskarcë, Komuna Saraj – Shkup |
| Telefoni | 072219440 |
| Fax | 2059 – 602 |

| | |
|---|---|
| e-mail | ibe.palikuqa@gmail.com<br>ou-ibepalikuqa-bojane-saraj@schools.mk |
| Themeluar prej | Komuna IDADIJA 1965 – katërvjeçare |
| Verifikimi – Numri i aktit | 11-587/16 – 31.01.1986 |
| Viti i verifikimit | 20 – 1986 |
| Gjuha në të cilën zhvillohet mësimi | Gjuhë shqipe, |
| Viti i ndërtimit | 1948 |
| Sipërfaqja e objektit | 325 $m^2$ |
| Sipërfaqja e oborrit shkollor | 306 $m^2$ |
| Shkolla punon në ndërime | Dy ndërime |
| Mënyra e nxemjes së shkollës | Me naftë |
| Numri i klasave | 5 |
| Numri i paraleleve | 10 |
| Numri i ndërimeve | 2 |

| | |
|---|---|
| Emri i shkollës | Shkolla F.K " " IBE PALIKUQA "" - f. Paniçarë |
| Adresa, komuna, vendi | f. Paniçarë – Komuna Saraj – Shkup |
| Telefoni | 072219440 |
| Fax | 2051-054 |
| e-mail | ibe.palikuqa@gmail.com<br>ou-ibepalikuqa-bojane-saraj@schools.mk |
| Themeluar prej | Komuna IDADIJA 1965 – katërvjeçare |
| Verifikimi – Numri i aktit | 11-587/16 – 31.01.1986 |
| Viti i verifikimit | 20 – 1986 |
| Gjuha në të cilën zhvillohet mësimi | Gjuhë shqipe |
| Viti i ndërtimit | 1967 |
| Sipërfaqja e objektit | 108 $m^2$ |
| Sipërfaqja e oborrit shkollor | 150 $m^2$ |
| Shkolla punon në ndërime | Një ndërim |
| Mënyra e nxemjes së shkollës | Me drunj |

SHFK IBE PALIKUQA - BOJANË

| | |
|---|---|
| Numri i klasave | 4 |
| Numri i paraleleve | 4 |
| Numri i ndërimeve | 1 |

Kushtet hapësirore për punën e shkollave

| | | | |
|---|---|---|---|
| Numri i përgjithshëm i ndërtesave shkollore | 3 | | |
| Numri i shkollave periferike | 2 | | |
| Sipërfaqja bruto | 1730 $m^2$ | | |
| Sipërfaqja neto | 1098 $m^2$ | | |
| Numri i tereneve sportive | 2 | | |
| Numri i kateve | 1 | | |
| Numri i mësonjëtoreve | 9 | | |
| Numri i hapësirave ndihmëse | 3 | | |
| Biblioteka shkollore | 1 | | |
| Mënyra e ngrohjes së shkollës | Me naftë dhe drunjë | | |

| | |
|---|---|
| Këshilli i shkollës<br>(Emri dhe mbiemri) | 1. Zamir Avdiu - Kolegiumi arsimorë<br>2. Rauf Pajaziti - Kolegiumi arsimorë<br>3. Zade Ademi - Kolegiumi arsimorë<br>4. Qenan Ramadani - Komuna e Sarajit<br>5. Tefik Memedi - Këshilli I prindërve (kryetar)<br>6. Azem Zendeli - Këshilli i prindërve<br>7. Agron Ajdini - Këshilli i prindërve<br>8. Samet Misimi - Këshilli i prindërve |
| Aktivet profesionale ( llojet ) | Aktivi i gjuhëtarëve - udhëheqës: Zade Ademi<br>Aktivi i lëndëve natyrore - udhëheqës: Zejnie Jakupi<br>Aktivi i shkathtësive - udhëheqës: Zamir Avdiu<br>Aktivi i klasave të ulta – Rakibe Beluli |

| | |
|---|---|
| Bashkësia e klasës (numri i nxënësve) | 50 |

| Klasa | Gjithsej | Struktura etnike dhe gjinore e punësuarve | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Maqedonë | | Shqiptarë | | Turq | | Romë | | Të tjerë | |
| | | M | f | m | f | m | F | m | f | M | f |
| Numri i të punësuarve | 63 | / | | 28 | 35 | | | | | | |
| Numri i kudrit arsimor | 49 | / | | 17 | 32 | | | | | | |
| Numri i bashkëpunëtorëve profesional | 3 | / | / | 1 | 2 | | | | | | |
| Punëtorë administrativ | 2 | / | / | 1 | 1 | | | | | | |
| Shërbimi teknik | 8 | / | / | 8 | / | | | | | | |
| Drejtor | 1 | / | / | 1 | / | | | | | | |

## Misioni i shkollës

Roli kryesor dhe misioni i kësaj shkolle është që të mësojë dhe arsimojë nxënës të të gjitha bashkësive etnike, bazuar në konceptin për edukim dhe arsim fillor nëntëvjeçar duke implementuar suksesshëm programet e reja mësimore dhe duke i pajisur me njohuri të nevojshme, shkathtësi dhe aftësi që të përballen me sukses me të gjitha vështirësitë që dalin nga procesi edukativo-arsimor.

Misioni i shkollës do të lëvizë në drejtim të aftësimit dhe edukimit të nxënësve të të gjitha bashkësive etnike, për një sjellje shoqërore me përgjegjësi ndaj shkollës, shokëve e shoqeve dhe rrethit ku jetojnë veprojnë, mbi baza të parimeve demokratike, tolerancës, mirëkuptimit të ndërsjellë të posedimit të iniciativave, konstruktivitetit dhe aftësisë.

Duke u nisur roli mjaft i rëndësishëm edukativo-arsimorë dhe roli në mjedisin ku vepron dhe shoqëritë në përgjithësi, kjo shkollë do të jetë e hapur për bashkëpunim me të gjitha subjektet e interesuara, e në veçanti me mjedisin lokal, prindët, komunën etj.

## Vizioni i shkollës

Vizioni i kësaj shkolle do të bazohet në shumë komponente që kanë të bëjnë me programet sa më të përsosura eduativo-arsimore, kualifikimet dhe rikualifikimet e trupit edukativo-arsimor dhe aftësimin permanent të tyre profesional në përputhshmëri me kërkesat e kohës në iniciativat e ndryshme individuale dhe kolektive në organe, organizata, këshillat prindërore, subjekte të ndryshme komunale dhe republikane që kanë të bëjnë me arsimin fillor dhe më gjërë nga bashkëpunimi në mjedisin lokal, Komuna e Sarajit si dhe faktorë të tjerë të ndryshëm të jashtëm e të brendshëm.

Duke u nisur gjendja momentale në shkollë, rezultatet e deritanishme, punës dhe angazhimit profesional te kuadrit arsimor, rrethanat e ndryshme pozitive, vizionin e shkollës sonë e definojmë si imperative që :

“ Të ndërtojë kushte të shkëlqyeshme për mësim bashkëkohor më forma, metoda dhe mjete të reja për mësim, duke bashkëpunuar vazhdimisht me prindët e nxënësve dhe duke u bërë shëmbull për gjeneratat e reja të të gjitha bashkësive etnike “.

# Hyrje

Në bazë të Nenit 129 paragrafi 1,2,3,4 dhe 5 i Ligjit për arsim fillor ( Gazeta zyrtare e RMV nr.161/19 dhe 229/20) drejtori i SHFK Ibe Palikuqa – f.Bojanë solli vendim për formimin e ekipit për vetëevaluimin e shkollës për periudhën 2022-2024.Ekipi për vetëevaluim përgaditi raport për punën e shkollës për periudhën 2022/23-2023/24.
Vlersimi i vazhdueshëm i kualitetit të punës së shkollës,me qëllim përmirsim e punës dhe zhvillimin e vazhdueshëm është një nga detyrat kryesore të sistemit arsimor.Kualiteti i një shkolle përcaktohet nga disa faktor,duke përfshirë arritjet e nxënësve,klimën dhe kulturën e shkollës,kualitetin e mësimit dhe nxënies,politikat e menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës.
Qëllimi i vetëevaluimit është që me analiza konkrete të të gjitha sferave të punës së shkollës të fitohet një pasqyrë për kualitetin e punës,përparimin dhe arritjet e shkollës,anët e forta dhe të dobëta për të cilat do të ofrohen propozim masa për tejkalimin e tyre.
Ky dokument paraqet indikatorët kryesor për vlersimin e kualitetit të punës së shkollës,me përshkrime të praktikave të mira drejt të cilave duhet të synojnë të gjitha shkollat.Nga analizat e bëra gjatë zbatimit të vetëevaluimit për periudhën 2022/23-2023/24,rezultatet me propozim masa për përmirsimin e kualitetit të procesit edukativo-arsimor komisioni ja dorëzon këshillit të shkollës,drejtorit të shkollës dhe themeluesit.Propozim masat këshilli i shkollës dhe drejtori i marrin parasysh gjatë përgaditjes dhe përpilimit të programës vjetore të shkollës dhe programin zhvillimor.

Përshkrimi i sferave,indikatorëve,temave dhe niveleve

1.SFERA 1- Planifikimi,mësimi dhe nxënia

2.SFERA 2 - Arritjet e nxënësve

3.SFERA 3- Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë

4.SFERA 4- Menaxhimi,udhëheqja dhe hartimi i politikave

Çdo sferë kryesore përmban numër të caktuar indikatorësh për kualitet.

Shemb.Sfera 1.Planifikimi,mësimi dhe nxënia i përmban indikatorët për kualitet si vijon:

1.1 Planifikimi i mësimdhënësve
1.2 Procesi mësimor
1.3 Përvojat e nxënësve nga nxënia
1.4 Vlersimi si pjesë e mësimit
1.5 Aktivitetet dhe garat jashtëshkollore

Secili indikatorë ka numër të caktuar të temave që kanë të bëjnë me aktivitet të caktuar që ndiqet në shkollë.

Shemb. Indikatori

1.3 Përvojat e nxënësve nga nxënia i përfshijnë temat si vijon:

1.3.1 Mjedisi dhe atmosfera për nxënie

1.3.2 Identifikimi dhe plotësimi i nevojave të ndryshme arsimore të nxënësve

| SFERA 1. PLANIFIKIM, MËSIM DHE NXËNIE | | |
|---|---|---|
| **numri** | **indikatori** | **tema** |
| 1.1 | Planifikimet e mësimdhënësve | • Mbështetja dhe ndjekja e planifikimeve të mësimdhënësve<br>• Shkëmbimi i përvojave dhe informacionet gjatë planifikimit |
| 1.2 | Procesi mësimor | • Realizimi i planeve dhe programeve mësimore<br>• Përzgjedhja e lëndëve mësimore<br>• Përzgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve<br>• Ndërveprimi mes mësimdhënësve dhe nxënësve dhe nxënësve mes vete<br>• Realizimi i inkluzionit arsimor<br>• Aktivitete për integrimin ndëretnik në arsim |
| | | |
| 1.3 | Përvoja e nxënësve nga nxënia | • Mjedisi dhe atmosfera për nxënie<br>• Identifikimi dhe plotësimi i nevojave të ndryshme arsimore të nxënësve |
| 1.4 | Notimi si pjesë e mësimit | • Politika shkollore për notim<br>• Metodat, format dhe instrumentet e notimit<br>•Koeficienti i vazhdimësisë së suksesit të nxënësve<br>• Përdorimi i informacioneve nga vlerësimi i mësimit |
| 1.5 | Aktivitete dhe gara jashtëshkollore | • Vëllimi dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara jashtëshkollore<br>• Mbulimi i nxënësve të gjinive dhe gjuhës të ndryshme mësimore me aktivitete jashtëshkollore<br>• Përfshirja e nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e punës në aktivitetet jashtëshkollore<br>• Gara |

| | | |
|---|---|---|
| **SFERA 2: ARRITJET E NXËNËSVE** | | |
| 2.1 | Arritjet e nxënësve | • Ndjekja e arritjeve të nxënësve të gjinive dhe gjuhëve të ndryshme mësimore sipas lëndëve mësimore dhe sipas periudhave të kualifikimit<br>• Rezultatet e testimeve eksterne<br>• Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me vështirësi në nxënie, nxënësve të talentuar dhe nxënësve me aftësi të kufizuara<br>• Njoftimi i prindërve/kujdestarëve për arritjet e nxënësve |
| 2.2 | Masat për përmirësimin e arritjeve | • Rregullsia në mësim<br>• Këshillimi i prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve<br>• Përmirësimi i arritjeve të nxënësve përmes mësimit të rregullta dhe plotësues |
| **SFERA 3: KLIMA SHKOLLORE** | | |
| 3.1 | Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë | • Reputacioni/imazhi i shkollës<br>• Kodi i Sjelljes<br>• Klima shkollore<br>• Sjellja dhe disiplina në shkollë<br>• Pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje dhe zgjidhjen e problemeve |
| 3.2 | Barazia dhe drejtësia | • Njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve<br>• Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve |
| 3.3 | Marrëdhënie partneriteti me bashkësinë | • Bashkëpunimi i shkollës me prindërit/kujdestarët<br>• Bashkëpunimi me komunën dhe me bashkësinë urbane |

| | | |
|---|---|---|
| 3.4 | Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit | • Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna<br>• Mbrojtje nga pirja e duhanit, alkooli dhe nga droga<br>• Kualiteti i ushqimit në dispozicion<br>• Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet<br>• Kujdesi për sigurinë e nxënësve dhe të punësuarve<br>• Kujdesi për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale<br>• Kujdesi për nxënësit me probleme shëndetësore<br>• Kujdesi për mirëqenien socio-emocionale të nxënësve<br>• Dhënia e ndihmës gjatë përzgjedhjes për vazhdimin e arsimit |
| **SFERA 4: MENAXHIMI, UDHËHEQJA DHE HARTIMI I POLITIKAVE** | | |
| 4.1 | Menaxhimi dhe udhëheqja e shkollës | • Menaxhimi i shkollës<br>• Udhëheqja e shkollës<br>• Menaxhimi dhe udhëheqja e resurseve<br>• Udhëheqja e kuadrit<br>• Ndjekja dhe përmirësimi i procesit mësimor |
| 4.2 | Qëllimet dhe hartimi i politikës shkollore | • Procedurat për hartimin e politikave shkollore<br>• Rezultatet e planifikimit zhvillimor<br>• Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit të shkollës |

RAPORT PËR VETËEVALUIMIN E SHKOLLËS 2022/2023-2023/2024

Sfera 1: Planifikimi, mësimi dhe nxënia

| Indikatori | Tema | Përshkruesit |
|---|---|---|
| Planifikime të mësimdhënësve | • Mbështetja dhe ndjekja e planifikimeve të mësimdhënësve | **Pjesërisht kënaq**<br><br>Shkolla siguron trajnime për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë për aplikimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore në planifikimin e mësimit. Diseminacioni nuk bëhet gjithmonë nga trajnimet e zhvilluara për planifikimet e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë.<br><br>Në fillim të vitit shkollor shqyrtohen planifikimet e mësimdhënësve nga drejtori, nga bashkëpunëtorët profesionalë dhe/ose nga personat e emëruar nga organet profesionale, por nuk ka procedura për dhënien e mbështetjes për përmirësim. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Shkëmbimi i përvojave dhe informacioneve gjatë planifikimit | **Shumë mirë**<br><br>Mësimdhënësit së paku dy herë në gjysmëvjetor shkëmbejnë përvoja për planifikimet në kuadër të aktiveve profesionale, përdorin përvoja profesionale nga media të ndryshme dhe nga bashkëpunimi rajonal me shkollat e tjera. Planifikimet te një numër i madh i mësimdhënësve janë përmirësuar si rezultat i shkëmbimit të përvojave dhe përdorimit të përvojave profesionale nga media të ndryshme, nga bashkëpunimi rajonal me shkolla të tjera, etj. |

**Dokumente**

Planet dhe programet mësimore të miratuara nga MASH

Standardet Kombëtare për arritjet e nxënësve në fund të arsimit fillor

**Burimet e të dhënave**

Programi vjetor i punës së shkollës; planifikime të mësimdhënësve; listat, agjendat dhe raportet nga trajnimet e realizuara; procesverbalet dhe listat e mbledhjeve të aktivave profesionale; anketat me mësimdhënësit; intervistat me drejtorin, bashkëpunëtorët profesionalë; raportet nga bashkëpunëtorët profesionalë për planifikimet e ndjekura.

| | | |
|---|---|---|
| Procesi mësimor | • Realizimi i planeve dhe programeve mësimore | **Shumë mirë**<br>Mësimi në mësimin klasor dhe në të gjitha lëndët mësimore realizohet rregullisht dhe në vëllimin e përcaktuar. Në raste të mungesës së mësimdhënësit (pushimi i lindjes, pushimi mjekësor, etj.), mësimi zhvillohet pa probleme me kuadrin përkatës mësimor. |
| | • Përzgjedhja e lëndëve mësimore | **Shumë mirë**<br>Aktivitetet dhe lëndët zgjedhore/ të lira janë në përputhje me planet dhe programet mësimore, Doracakun për lëndë të lira zgjedhore në arsimin fillor dhe procedurat e përcaktuara në shkollë, në të cilat janë përfshirë interesat e nxënësve.[1] |

[1]Përjashtim bëjnë shkollat me një numër të vogël nxënësish në të cilat lista e lëndëve zgjedhore, në marrëveshje me nxënësit (respektivisht me prindërit/kujdestarët e tyre), mund të jetë më e kufizuar

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| | • Përzgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve | **Shumë mirë**<br>Të gjithë mësimdhënësit, detyrat dhe aktivitetet i përshtatin me nevojat individuale arsimore të nxënësve. Me këtë rast, mësimdhënësit përdorin qasje dhe resurse të ndryshme për nxënie dhe mësim, duke mos u kufizuar vetëm në librat shkollorë dhe literaturën manuale shtesë. Resurset në dispozicion përdoren në mënyrë funksionale duke përdorur qasje moderne në mësimin si: mësimi me përvojë, mësimi përmes projektit, mësimi përmes zgjidhjes së problemeve, mësimi përmes lojës, mësimi përmes hulumtimit, aplikimi i veglave dhe programeve digjitale, etj. Për nxënësit me NVA, përdoren metodat dhe teknikat sipas nevojave të tyre. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Ndërveprimi mes mësimdhënësve dhe nxënësve dhe nxënësve mes vete | **Shumë mirë**<br>Të gjithë mësimdhënësit sillen me nxënësit në mënyrën që promovon pranimin, respektin, bashkëpunimin dhe mirëkuptimin. Numri më i madh i mësimdhënësve sigurojnë mundësi të barabarta për përfshirje dhe i përfshijnë të gjithë nxënësit gjatë orëve mësimore.<br>Në numrin më të madh të orëve mësimore, ekziston ndërveprimi mes mësimdhënësit dhe nxënësve që shpie drejt arritjes së qëllimeve të orës.<br>Në numrin më të madh të orëve mësimore, zgjedhja e metodave dhe teknikave të aplikuara mundëson ndërveprimin mes nxënësve.<br>Numri më i madh i nxënësve konsiderojnë se mund të shprehen lirshëm gjatë orëve të mësimit. |

| | | |
|---|---|---|
| | | |

| | | |
|---|---|---|
| | • Realizimi i inkluzionit arsimor | **Shumë mirë**<br><br>Ekipi inkluziv i shkollës dhe ekipi inkluziv i nxënësit janë formuar me Aktvendim/Vendim të drejtorit të shkollës. Ato përditësohen rregullisht me mbarimin e mandatit ose ndryshimin e mësimdhënësve të nxënësit me NVA. Ekipi inkluziv siguron mbështetje për përpilimin e PIA-s në të gjitha lëndët, në përputhje me rregullativën ligjore.<br><br>Me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, aktivitetet mësimore/jashtëshkollore realizohet sipas PIA dhe/ose programi të modifikuar sipas rekomandimeve të KNF (Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionalitetit). Shkolla bashkëpunon në mënyrë aktive me qendrën kompetente të resurseve për të avancuar mësimin për nxënësit me aftësi të kufizuara. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë janë të trajnuar për të planifikuar dhe realizuar mësim me nxënës me NVA.<br><br>Teknologjia asistive që e ka në dispozicion shkolla është në funksion të zhvillimit të nxënësve me NVA. Qasja në shkollë, hapësira në korridore dhe në klasat, tualetet nuk janë përshtatur për nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike. Mësimdhënësit vlerësojnë arritjet e nxënësve me NVA në përputhje me qëllimet në planin individual arsimor, në bashkëpunim me ekipin inkluziv të nxënësit.<br><br>Shkolla siguron kushte për pjesëmarrjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në aktivitete jashtëshkollore në përputhje me interesat e tyre.<br><br>Nxënësit me aftësi të kufizuara të cilët kanë nevojë për asistencë personale dhe/ose arsimore identifikohen me kohë dhe dorëzohet kërkesë për mbështetje përkatëse. Kuadri mësimor bashkëpunon me sukses me asistentët arsimorë me qëllim të interesin më të mirë për nxënësin.<br><br>Ekipi inkluziv punon në orientimin profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Aktivitete për Integrim Ndëretnik në Arsim | **Pjesërisht kënaq**<br>EISH ndjekë realizimin e aktiviteteve INA të PVPSH, aktivitetet e projektit të marra përmes granteve nga MASH-i. EISH rregullisht plotëson pyetësorët anketues për nevojat e Komisionit për avancimin e INA-s në MASH.<br>Në shkollat që realizojnë mësim në disa gjuhë mësimore, ka shembuj të aktiviteteve të realizuara jashtëshkollore me grupe të balancuara gjuhësore heterogjene të nxënësve. |

**Dokumente**

Koncepti për arsimin fillor (MASH/BZHA, 2020)

Koncepti për arsimit inkluziv (BZHA, 2020)

Udhëzues për lëndët e lira zgjedhore në arsimin fillor (DBE, 2021) Udhëzuesi i punës së ekipit inkluziv shkollor (BZHA, 2018)

Udhëzues për lëndët e lira zgjedhore (BZHA, 2021)

Udhëzim për organizimin e orëve të përbashkëta mësimore (QMEQ, 2021)

**Burimet e të dhënave**

Programi vjetor i punës së shkollës; orari i orëve të mësimit; e-ditar; evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik; listat dhe raportet e trajnimeve të realizuara; procesverbalet e mbledhjeve të aktiveve profesionale; anketat me mësuesit; studentët, prindërit; diskutimet në grupe fokusi me nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit; intervistat me drejtorin, bashkëpunëtorët profesionalë; raportet nga vizitat në orët mësimore; zgjidhjet për ekip inkluziv të shkollës; PIA të përpiluara dhe programe të modifikuara për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore; procesverbalet e takimeve të ekipeve shkollore për inkluzion dhe ekipe inkluzive për nxënës; raportet dhe procesverbalet e ekipeve të integrimit shkollor (EISH), raportet e

| | | |
|---|---|---|
| Përvojat e nxënësve nga nxënia | Mjedisi dhe atmosfera për nxënie | **Pjesërisht kënaq**<br><br>Nxënësit dhe prindërit e përjetojnë shkollën si një mjedis të sigurt, por pjesërisht stimulues, inkluziv, interkulturor dhe motivues. Nxënësit nuk kanë qasje të plotë në materiale të ndryshme për nxënie.<br><br>Nxënësit konsiderojnë se mënyra në të cilën mësohet në një numër të vogël të orëve në shkollë është interesante. Gjatë orëve të mësimit, një numër i vogël i nxënësve nxiten që të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe kritike, të bëjnë pyetje dhe të nxjerrin konkluzione për atë që e mësojnë.<br><br>Një numër i vogël i mësimdhënësve përdorin mënyra të ndryshme për të motivuar nxënësit. |

| | | |
|---|---|---|
| | | |

| | | |
|---|---|---|
| | • Identifikimi dhe plotësimi i nevojave të ndryshme arsimore të nxënësve | **Pjesërisht kënaq**<br><br>Kuadri mësimor dhe bashkëpunëtorët profesionalë nuk e bëjnë sistematikisht identifikimin e nevojave dhe pengesave në procesin e nxënies së nxënësve. Në procesin e nxënies, ndërmarrin aktivitete për plotësimin e nevojave dhe/ose për të hequr pengesat gjatë nxënies. Një numër i vogël i mësimdhënësve, në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesionalë, përdorin teknika të ndryshme interaktive në procesin e mësimdhënies, prandaj një pjesë e nxënësve me nevoja të ndryshme arsimore nuk mund t'i arrijnë qëllimet e planifikuara. |

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| **Burimet e të dhënave**<br><br>Anketë me nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit; bisedë në grupe fokusi me nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit; bisedë me shërbimin profesional; qasje në dosjet e nxënësve; qasje në evidencën e bashkëpunëtorëve profesionalë. | | |

| | | |
|---|---|---|
| Notimi si pjesë e mësimit | • Politika shkollore e notimit | **Shumë mirë**<br><br>Shkolla zbaton politikë të paracaktuar të notimit, duke përfshirë edhe kodin e notimit, qëllimi kryesor i të cilit është të mbështesë nxënien e secilit nxënës.<br><br>Shkolla në nivelin e aktiveve profesionale ka kritere të ndërtuara të notimit, në përputhje me standardet kombëtare të arritjeve. Kriteret e harmonizuara në aktivet profesionale, mësimdhënësit i përdorin për të notuar nxënësit dhe me to janë të njoftuar nxënësit dhe prindërit.<br><br>Numri më i madh i mësimdhënësve aplikojnë notim formativ. Notimi formativ dhe sumativ është publik dhe transparent për nxënësit. |
| | • Metodat, format dhe instrumentet e notimit | **Shumë mirë**<br><br>Mësimdhënësit përdorin metoda, forma dhe instrumente të shumëllojshme për të notuar dhe ndjekur vazhdimisht përparimin e nxënësve. Nxënësit përfshihen në notimin (përmes vetënotimit, notimit të ndërsjellë, ndërtimit të kritereve, udhëheqjes së portofoleve, etj.). Instrumentet e notimit avancohen në bashkëpunim me shërbimin profesional. |

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| | • Koeficienti i vazhdimësisë së suksesit të nxënësve | **Pjesërisht kënaq**<br><br>Koeficienti i vazhdimësisë së suksesit, në periudhën e tretë të arsimit nga tri vitet vijuese paraprake, i përllogaritur si raport i suksesit mesatar të shkollës në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit është më i madh se 0,6, e më i vogël se 0.7. |
| | • Përdorimi i informacioneve nga notimi në mësim | **Shumë mirë**<br><br>Mësimdhënësit i përdorin të gjitha informacionet që i kanë marrë nga notimi në mënyrë që t'i përmirësojnë planifikimet dhe realizimin e mësimit. Të gjithë mësimdhënësit u japin rregullisht informacione kthyese nxënësve për punën e tyre, diskutojnë me nxënësit për përparimin dhe arritjet e tyre dhe sipas nevojës i përfshijnë në mësimin shtesë ose plotësues. |
| **Dokumente**<br><br>Standarde kombëtare për arritjet e nxënësve në fund të arsimit fillor (BZHA, 2021) | | |
| Kritere për notimin e arritjeve të nxënësve (BZHA) | | |

<table>
<tr><td colspan="3">Burimet e të dhënave<br><br>Program për punën e shkollës; orar për mësim shtesë dhe plotësues; lista të nxënësve të përfshirë në mësimin shtesë dhe plotësues; rregullore për notim dhe avancim të nxënësve; rregullore interne për notim; qasje në evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik; instrumente të përdorura për notim; shembuj të punimeve të notuara të nxënësve; procesverbale nga aktivet profesionale, këshillat e mësimdhënësve; anketa/intervista me nxënësit dhe mësimdhënësit, prindërit; instrumentet për mënyra të individualizuara të kontrollit</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Aktivitete dhe gara jashtëshkollore</td><td>• Vëllimi i llojllojshmërisë së aktiviteteve dhe garave jashtëshkollore</td><td>Pjesërisht kënaq<br><br>Shkolla planifikon, por nuk i realizon tërësisht aktivitete e planifikuar jashtëshkollore. Aktivitetet jashtëshkollore janë kufizuar sipas llojit dhe i reflektojnë në mënyrë të pamjaftueshme nevojat dhe interesat e nxënësve.</td></tr>
<tr><td>• Përfshirja e nxënësve me aktivitete jashtëshkollore</td><td>Pjesërisht kënaq<br><br>Një numër i vogël nxënësish janë të përfshirë së paku në një aktivitet jashtëshkollor.<br>Në shkollë, me nxënësit e ciklit të tretë arsimor, janë realizuar aktivitete shoqërore humanitare, në kuadër të aktiviteteve jashtëshkollore.</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | • Përfshirja e nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e aktiviteteve jashtëshkollore | **Pjesërisht kënaq**<br>Një numër i vogël i nxënësve janë të njoftuar me aktivitetet jashtëshkollore që ofrohen në shkollë. Rekomandimet e mësimdhënësve janë vendimtare në përzgjedhjen e aktiviteteve jashtëshkollore, si dhe në planifikimin e përmbajtjeve të aktiviteteve. |

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| | • Gara | **Shumë mirë**<br>Shkolla organizon gara shkollore për seleksionimin e nxënësve për gara në nivel më të lartë. Nxënësit, me ndihmën dhe mbështetjen e shkollës dhe të mësimdhënësve, marrin pjesë në gara të sferave të ndryshme që organizohen në nivel komunal, rajonal, shtetëror (nga shoqatat e akredituara të mësimdhënësve) ose ndërkombëtar, si dhe aktivitetet tjera me karakter garues. |
| **Dokumente**<br>Koncepte për aktivitete jashtëshkollore në arsimin fillor (BZHA, 2020) | | |

| |
|---|
| rajonal dhe shtetëror në arsimin fillor (MASH, 2019 dhe 2020-plotësim)<br><br>**Burimet e të dhënave**<br><br>Programi vjetor i punës; programi për aktivitete jashtëshkollore; raport nga ekskursionet e realizuara; evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik; diploma, mirënjohje, lëvdata nga pjesëmarrja në manifestime dhe gara; intervista/anketa me mësimdhënës, prindër, nxënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë për aktivitete jashtëshkollore; procesverbale nga aktivet profesionale dhe bashkësia e nxënësve; lista e nxënësve të përfshirë në aktivitete jashtëshkollore; qasje në faqen e internetit, në gazetat, programin e radios, rrjetet sociale, etj. |

Sfera 1: Planifikimi, mësimi dhe nxënia

Pjesërisht kënaq

| |
|---|
| Përshkrim/përmbledhje e sferës(fushës)<br><br>Shkolla siguron trajnime për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë për aplikimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore në planifikimin e mësimit. Diseminacioni nuk bëhet gjithmonë nga trajnimet e zhvilluara për planifikimet e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë.<br>Në fillim të vitit shkollor shqyrtohen planifikimet e mësimdhënësve nga drejtori, nga bashkëpunëtorët profesionalë dhe/ose nga personat e emëruar nga organet profesionale, por nuk ka procedura për dhënien e mbështetjes për përmirësim.<br><br>Mësimdhënësit së paku dy herë në gjysmëvjetor shkëmbejnë përvoja për planifikimet në kuadër të aktiveve profesionale, përdorin përvoja profesionale nga media të ndryshme dhe nga bashkëpunimi rajonal me shkollat e tjera. Planifikimet te një numër i madh i mësimdhënësve janë përmirësuar si rezultat i shkëmbimit të përvojave dhe përdorimit të përvojave profesionale nga media të ndryshme, nga bashkëpunimi rajonal me shkolla të tjera, etj.<br>Mësimi në mësimin klasor dhe në të gjitha lëndët mësimore realizohet rregullisht dhe në vëllimin e përcaktuar. Në raste të mungesës së mësimdhënësit (pushimi i lindjes, pushimi mjekësor, etj.), mësimi zhvillohet pa probleme me kuadrin përkatës mësimor.<br>Aktivitetet dhe lëndët zgjedhore/ të lira janë në përputhje me planet dhe programet mësimore, Doracakun për lëndë të lira zgjedhore në arsimin fillor dhe procedurat e përcaktuara në shkollë, në të cilat janë përfshirë interesat e nxënësve.<br>Të gjithë mësimdhënësit, detyrat dhe aktivitetet i përshtatin me nevojat individuale arsimore të nxënësve. Me këtë rast, mësimdhënësit përdorin qasje dhe resurse të ndryshme për nxënie dhe mësim, duke mos u kufizuar vetëm në librat shkollorë dhe literaturën manuale shtesë.Për nxënësit me NVA, përdoren metodat dhe teknikat sipas nevojave të tyre. |

| |
|---|
| Të gjithë mësimdhënësit sillen me nxënësit në mënyrën që promovon pranimin, respektin, bashkëpunimin dhe mirëkuptimin. Numri më i madh i mësimdhënësve sigurojnë mundësi të barabarta për përfshirje dhe i përfshijnë të gjithë nxënësit gjatë orëve mësimore.<br>Në numrin më të madh të orëve mësimore, ekziston ndërveprimi mes mësimdhënësit dhe nxënësve që shpie drejt arritjes së qëllimeve të orës. Numri më i madh i nxënësve konsiderojnë se mund të shprehen lirshëm gjatë orëve të mësimit.<br>Ekipi inkluziv i shkollës dhe ekipi inkluziv i nxënësit janë formuar me Aktvendim/Vendim të drejtorit të shkollës. Ato përditësohen rregullisht me mbarimin e mandatit ose ndryshimin e mësimdhënësve të nxënësit me NVA. Ekipi inkluziv siguron mbështetje për përpilimin e PIA-s në të gjitha lëndët, në përputhje me rregullativën ligjore.<br>Me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, aktivitetet mësimore/jashtëshkollore realizohet sipas PIA dhe/ose programi të modifikuar sipas rekomandimeve të KNF (Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionalitetit). Shkolla bashkëpunon në mënyrë aktive me qendrën kompetente të resurseve për të avancuar mësimin për nxënësit me aftësi të kufizuara. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë janë të trajnuar për të planifikuar dhe realizuar mësim me nxënës me NVA.<br>EISH ndjekë realizimin e aktiviteteve INA të PVPSH, aktivitetet e projektit të marra  përmes granteve nga MASH-i. EISH rregullisht plotëson pyetësorët anketues për nevojat e Komisionit për avancimin e INA-s në MASH.<br>Nxënësit dhe prindërit e përjetojnë shkollën si një mjedis të sigurt, por pjesërisht stimulues, inkluziv, interkulturor dhe motivues. Nxënësit nuk kanë qasje të plotë në materiale të ndryshme për nxënie.<br>Një numër i vogël i mësimdhënësve, në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesionalë, përdorin teknika të ndryshme interaktive në procesin e mësimdhënies, prandaj një pjesë e nxënësve me nevoja të ndryshme arsimore nuk mund t’i arrijnë qëllimet e planifikuara.<br>Shkolla zbaton politikë të paracaktuar të notimit, duke përfshirë edhe kodin e notimit, qëllimi kryesor i të cilit është të mbështesë nxënien e secilit nxënës.<br>Mësimdhënësit përdorin metoda, forma dhe instrumente të shumëllojshme për të notuar dhe ndjekur vazhdimisht përparimin e nxënësve. Mësimdhënësit i përdorin të gjitha informacionet që i kanë marrë nga notimi në mënyrë që t’i përmirësojnë planifikimet dhe realizimin e mësimit. Të gjithë mësimdhënësit u japin rregullisht informacione kthyese nxënësve për punën e tyre, diskutojnë me nxënësit për përparimin dhe arritjet e tyre dhe sipas nevojës i përfshijnë në mësimin shtesë ose plotësues.<br>Shkolla planifikon, por nuk i realizon tërësisht aktivitete e planifikuar jashtëshkollore. Aktivitetet jashtëshkollore janë kufizuar sipas llojit dhe i reflektojnë në mënyrë të pamjaftueshme nevojat dhe interesat e nxënësve.<br>Shkolla organizon gara shkollore për seleksionimin e nxënësve për gara në nivel më të lartë. Nxënësit, me ndihmën dhe mbështetjen e shkollës dhe të mësimdhënësve, marrin pjesë në gara të sferave të ndryshme që organizohen në nivel komunal, rajonal, shtetëror (nga shoqatat e akredituara të mësimdhënësve) ose ndërkombëtar, si dhe aktivitetet tjera me karakter garues. |

Anët e forta

- Ndjekje e rregullt e seminareve dhe trajnimeve nga ana e arsimtarëve për planet dhe programet mësimore.
- Rregullisht arsimtarët përgatisin planifikime tematike-vjetore nga ana e arsimtarëve klasore dhe lëndor.
- Aktivitetet për orët e lira realizohen nëpërmjet sekcioneve të ndryshme.
- Shkolla realizon arsimim për të drejtat e njeriut në mësimin klasor nëpërmjet lëndës së shoqëris dhe në mësimin lëndor arsimimi qytetar.
- Shkolla realizon aktivitete jashtëmësimore, aktivitete proektuese, aksione për ekskurzionet e nxënësve.
- Nxënësit kyçen në aktivitete jashtëmësimore në mënyrë të barabartë edhe gjinia femrore edhe mashkullore, përfaqësimi etnik dhe prejardhja sociale.

Anët e dobta

- Numër I vogël i arsimtarëve konsiderojnë se marrin mbështetje nga shërbimi professional.drejtori ose personi I autorizuar për përgaditjen e planeve mësimore.
- Numër I vogës I nxënësve konsiderojnë se nuk marrin instruksione të qarta se çfar duhet të mësohet për nota të caktuara.
- Numër I vogël I nxënësve konsiderojnë se nuk mund të shprehen lirshëm gjatë orëve mësimore.
- Numër I vogël I nxënësve konsiderojnë që nuk janë të përfshirë në mënyrë aktive në procesin mësimor,përmes pyetjeve,puna në grup apo diskutime.
- Mungesa e edukatorit special dhe rehabilitator dhe e asistentëve arsimor për nxënësit me NVA
- Mungesa e sallës sportive
- Mungesa e kabineteve mësimore dhe mjeteve didaktike për realizimin e mësimit bashkëkohor
- Numës I konsiderueshëm I kuadrit joadekuat
- Mungesa e teksteve shkollore dhe TIK

Prioritetet

- Kompletimi I kuadrit adekuat arsimor
- Sigurimi I eduaktorit special dhe rehabilitator dhe asistentëve arsimor
- Bashkpunimi ndëretnik me shkollën partnere
- Përfshirja e nxënësve në përgaditjen e planeve për aktivitetet jashtëmësimore në interest të tyre.

- Bashkpunim me komunën,MASH,BZHA dhe institucione tjera kompetente për përmirsimin e kushteve për mbarvajtjen e procesit edukativo arsimor.

Metodat që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave dhe informacionet e përpunuara

Anketa me prindërit/kujdestarët

Pyetsor për prindërit – planifikimi,mësimi dhe nxënia

90 prindër të anketuar

1.Fëmiju im gjatë vitit shkollor i ka të gjitha orët mësimore sipas orarit?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 75 | 83,4% |
| JO | 15 | 16,6% |

2.Jam i njoftuar me listën e lëndëve zgjedhore dhe aktiviteteve tjera mësimore?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 55 | 61,1% |
| JO | 35 | 38,2% |

3.Fëmiju im lirshëm mund të shprehet gjatë orëve mësimore?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 78 | 86,6% |
| JO | 12 | 13,4% |

4.Shkollën e ndjej si mjedis të sigurt për fëmijun tim?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 87 | 96,7% |
| JO | 3 | 3,3% |

5.Shkollën e ndjej si mjedis stimulues/motivues për fëmijun tim?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 63 | 70% |
| JO | 27 | 30% |

6.Fëmiju im në shkollë ka qasje në materiale të ndryshme mësimore (p.sh. enciklopedi,revista,internet etj)

| | | |
|---|---|---|
| PO | 17 | 18,9% |
| JO | 73 | 81,1% |

7.Arsimtarët përdorin lëvdatat për mundin e dhënë dhe sukseset e arritura të fëmijut tim?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 59 | 65,5% |
| JO | 31 | 34,6% |

8.Rregullisht jam i informuar për aritjet e fëmijut tim në shkollë (3 mujor,gjysmëvjetor dhe fundvit)?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 90 | 100% |
| JO | 0 | 0% |

9.Arsimtarët më njoftojnë me kriteriumet e notimit në lëndët e tyre?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 19 | 21.1% |
| JO | 71 | 78.9% |

10.Fëmiju im është i kyçur në aktivitetet jashtëmësimore sipas interesit të tij?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 11 | 12.2% |
| JO | 79 | 87.8% |

Anketa për mësimdhënësit

Pyetsor për mësimdhënësit – planifikimi,mësimi dhe nxënia

32 mësimdhënës të anketuar

1.Trajnimet i marrim në kohë për përdorimin e metodave dhe teknikave të reja për planifikimin e mësimdhënies?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 27 | 84.38% |
| JO | 5 | 15.62% |

2.Drejtori dhe shërbimi profesional i ndjekin planifikimet e mija së paku dy herë në gjysmëvjetor?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 13 | 40.62% |
| JO | 19 | 59.38% |

3.Në kuadër të aktiveve profesionale shkëmbejmë përvoja për planifikimet së paku dy herë në gjysmëvjetor?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 22 | 68.75% |
| JO | 10 | 31.25% |

4.Në mësimdhënie përdori resurse të ndryshme për mësim dhe mësimnxënie?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 26 | 81.25% |
| JO | 6 | 18.75% |

5.Në mësim përdori qasje që nxitin hulumtim dhe zhgjidhje të problemeve?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 19 | 59.37% |
| JO | 13 | 40.63% |

6.I nxis nxënësit të parashtrojnë pyetje kur nuk kuptojnë diçka apo duan të dinë më tepër?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 25 | 78.12% |
| JO | 7 | 21.88% |

7.Kam respekt ndaj të gjithë nxënësve?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 21 | 65.62% |
| JO | 11 | 34.38% |

8.Në orët e mija,orën e zhvilloj në mënyrë që të nxis interaksion në mes nxënësve?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 24 | 75% |
| JO | 8 | 25% |

9.Rregullisht përdor lëvdata tek nxënësit për sukseset e tyre dhe mundin e dhënë?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 26 | 81.25% |
| JO | 6 | 18.75% |

10.Përdor mënyra të ndryshme për notimin e nxënësve?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 29 | 90.62% |
| JO | 3 | 9.38% |

Anketa për nxënësit

Pyetsor për nxënësit – planifikimi,mësimi dhe nxënia

100 nxënës të anketuar

1.Në orë kam mundësi të mësoj në mënyra të ndryshme (shemb.nga projekte,lojë,hulumtim etj.)

| | | |
|---|---|---|
| PO | 58 | 58% |
| JO | 42 | 42% |

2.Në orë përdorim materiale të ndryshme për mësim (shemb. Enciklopedi,revista,internet etj)?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 43 | 43% |
| JO | 57 | 57% |

3.Në numrin më të madh të orëve,të gjithë nxënësit jemi të kyçur në mënyrë aktive në mësim (diskutojmë,pyesim..)?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 67 | 67% |
| JO | 33 | 33% |

4.Mësimdhënësit më përkrahin dhe më motivojnë të marrë pjesë në garra dhe projekte të ndryshme?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 64 | 64% |
| JO | 36 | 36% |

5.Mësimdhënësit më japin spjegime se përse kam marrë notë të caktuar?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 76 | 76% |
| JO | 24 | 24% |

6.Notimi është i drejtë për të gjithë nxënësit?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 67 | 67% |
| JO | 33 | 33% |

7.Mësimdhënësit përdorin mënyra të ndryshme për vlersimin e njohurime të mija (teste,vlersim verbale,çeklista etj)?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 83 | 83% |
| JO | 17 | 17% |

8.Mësimdhënësit më lavdërojnë për mundin e dhënë dhe për rezultatet e arritura?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 71 | 71% |
| JO | 29 | 29% |

9.Në orët mësimore ndjehem i/e lirë të parashtroj pyetje dhe ta shpreh mendimin tim?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 74 | 74% |
| JO | 26 | 26% |

10.Lëndët zgjedhore dhe aktivitetet jashtëmësimore i përzgjedh në bazë të interesave të mija?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 42 | 42% |
| JO | 58 | 58% |

Sfera 2: Arritjet e nxënësve

| Indikatorë | Tema | |
|---|---|---|
| Arritjet e nxënësve | • Ndjekje e arritjeve të nxënësve të gjinisë dhe gjuhës së ndryshme të mësimit sipas lëndëve mësimore dhe sipas periudhave të klasifikimit | **Pjesërisht kënaq**<br>Shkolla përzgjedhë, përdorë dhe analizon të dhënat për arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimit, nga të gjitha lëndët mësimore, për të gjitha periudhat e kualifikimit, por nuk ndërmerr aktivitete për përmirësim. Pjesëmarrja dhe arritjet në aktivitete jashtëshkollore evidentohet. |
| | • Rezultate nga testimet eksterne | **Pjesërisht kënaq**<br>Shkolla ishte e përfshirë në testimin ndërkombëtar TIMSS,PIRLS dhe QPSH dhe rezultatet nuk ishin shumë të mira.Rezultatet që janë marrë nga testimet shtetërore, studimet/raportet për vlerësime ndërkombëtare mblidhen, por nuk analizohen. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me vështirësi në nxënien, të nxënësve të talentuar dhe të nxënësve me aftësi të kufizuar | **Pjesërisht kënaq**<br><br>Shkolla i dallon nxënësit e talentuar, nxënësit që kanë vështirës në nxënien, si dhe nxënësit me pengesa në zhvillimin, por nuk e ndjekë me rregullt përparimin e tyre. Nxënësit kohë pas kohe marrin mbështetje për përmirësimin e arritjeve. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Njoftim të prindërve/kujdestarëve për arritjet e nxënësve | **Shumë mirë**<br><br>Shkolla ka sistem të përcaktuar për njoftimin e prindërve për përparimin e fëmijëve të tyre dhe e zbaton në mënyrë të përpiktë. Prindërit/kujdestarët marrin informacione për arritjet e nxënësve pas çdo periudhe të kualifikimit. Prindërit kanë mundësi të njoftohen me arritjet e fëmijës së tyre përmes e-ditarit që udhëhiqet rregullisht. |
| **Burimet e të dhënave**<br><br>E-ditari; procesverbalet nga mbledhjet prindërore, analiza të arritjeve sipas kritereve të ndryshme dhe periudha kualifikuese dhe planit të veprimit për përmirësim; analiza e rezultateve nga testimet eksterne; anketa me nxënës, mësimdhënës, prindër; intervista me bashkëpunëtorë profesionalë, drejtor. | | |

| | | |
|---|---|---|
| Masa për përmirësimin e arritjeve | • Rregullsia në mësim | **Shumë mirë**<br><br>Shkolla e ndjekë në mënyrë sistematike rregullsinë e nxënësve, analizon arsyet për mungesë nga mësimi dhe ndërmerr aktivitete konkrete. Bashkëpunon me prindërit/kujdestarët, institucionet (MPPS, qendrat për punë sociale etj..), vetëqeverisjen lokale dhe me organizatat qytetare në mënyrë që të rrisë rregullsinë e nxënësve në mësimin. Numri mesatar i mungesave të paarsyeshme midis dy evaluimeve integrale është më pak se pesë për nxënës.<br><br>Shkolla ndërmerr masa të veçanta për ndjekjen e rregullt të mësimit nga nxënësit e kategorive të rrezikuara, që japin rezultate. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Këshillim i prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve | **Shumë mirë**<br><br>Shkolla i realizon këshillimet e prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve, për çka udhëheqë dokumentacion të rregullt, i njofton institucionet kompetente, bën analizë të rezultateve nga këshillimi dhe e ndjekë përmirësimin e rregullsisë, suksesit dhe sjelljes së nxënësve. Këshillimet e prindërve/kujdestarëve rezultojnë me përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Këshillimet e nxënësve, në numrin më të madh kontribuojnë në përmirësimin e suksesit, rregullsisë dhe sjelljes. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Përmirësim i arritjeve të nxënësve përmes mësimit të rregullt dhe plotësues | **Pjesërisht kënaq**<br>Një numër i vogël i mësimdhënësve përdorin metoda, teknika, strategji në mësimin për përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Gjatë vitit nuk ka ndryshime në realizimin e mësimit në drejtim të përmirësimit të arritjeve. Shkolla, në nivel mujor, përpilon orar për mësim plotësues, por e realizon nga/ose në fund të vitit shkollor, vetëm në lëndë të caktuara mësimore.<br>Shkolla nuk analizon rezultatet nga mësimi plotësues dhe/ose i diferencuar nga aspekti i kontributit drejt arritjeve. |
| **Burimet e të dhënave**<br>Procesverbale nga këshillime të prindërve dhe nxënësve; orar dhe listë të mësimit plotësues dhe shtesë; E-ditari; raporte për bashkëpunim me faktorë të ndryshëm për përmirësimin e arritjeve. | | |

Sfera 2: Arritjet e nxënësve
Pjesërisht kënaq

| Përshkrim/përmbledhje e sferës(fushës) |
|---|

Shkolla përzgjedhë, përdorë dhe analizon të dhënat për arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimit, nga të gjitha lëndët mësimore, për të gjitha periudhat e kualifikimit, por nuk ndërmerr aktivitete për përmirësim. Pjesëmarrja dhe arritjet në aktivitete jashtëshkollore evidentohet.
Shkolla ishte e përfshirë në testimin ndërkombëtar TIMSS,PIRLS dhe QPSH dhe rezultatet nuk ishin shumë të mira.Rezultatet që janë marrë nga testimet shtetërore, studimet/raportet për vlerësime ndërkombëtare mblidhen, por nuk analizohen.
Shkolla ka sistem të përcaktuar për njoftimin e prindërve për përparimin e fëmijëve të tyre dhe e zbaton në mënyrë të përpiktë.
Prindërit/kujdestarët marrin informacione për arritjet e nxënësve pas çdo periudhe të kualifikimit. Prindërit kanë mundësi të njoftohen me arritjet e fëmijës së tyre përmes e-ditarit që udhëhiqet rregullisht.
Shkolla e ndjekë në mënyrë sistematike rregullsinë e nxënësve, analizon arsyet për mungesë nga mësimi dhe ndërmerr aktivitete konkrete. Bashkëpunon me prindërit/kujdestarët, institucionet (MPPS, qendrat për punë sociale etj..), vetëqeverisjen lokale dhe me organizatat qytetare në mënyrë që të rrisë rregullsinë e nxënësve në mësimin. Numri mesatar i mungesave të paarsyeshme midis dy evaluimeve integrale është më pak se pesë për nxënës.
Shkolla ndërmerr masa të veçanta për ndjekjen e rregullt të mësimit nga nxënësit e kategorive të rrezikuara, që japin rezultate.
Shkolla i realizon këshillimet e prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve, për çka udhëheqë dokumentacion të rregullt, i njofton institucionet kompetente, bën analizë të rezultateve nga këshillimi dhe e ndjekë përmirësimin e rregullsisë, suksesit dhe sjelljes së nxënësve. Këshillimet e prindërve/kujdestarëve rezultojnë me përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Këshillimet e nxënësve, në numrin më të madh kontribuojnë në përmirësimin e suksesit, rregullsisë dhe sjelljes.
Një numër i vogël i mësimdhënësve përdorin metoda, teknika, strategji në mësimin për përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Gjatë vitit nuk ka ndryshime në realizimin e mësimit në drejtim të përmirësimit të arritjeve. Shkolla, në nivel mujor, përpilon orar për mësim plotësues, por e realizon nga/ose në fund të vitit shkollor, vetëm në lëndë të caktuara mësimore.
Shkolla nuk analizon rezultatet nga mësimi plotësues dhe/ose i diferencuar nga aspekti i kontributit drejt arritjeve.

Anët e forta

- Shkolla përzgjedhë, përdorë dhe analizon të dhënat për arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimit, nga të gjitha lëndët mësimore, për të gjitha periudhat e kualifikimit.
- Prindërit/kujdestarët marrin informacione për arritjet e nxënësve pas çdo periudhe të kualifikimit. Prindërit kanë mundësi të njoftohen me arritjet e fëmijës së tyre përmes e-ditarit që udhëhiqet rregullisht.
- Shkolla e ndjekë në mënyrë sistematike rregullsinë e nxënësve, analizon arsyet për mungesë nga mësimi dhe ndërmerr aktivitete konkrete.
- Shkolla i realizon këshillimet e prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve, për çka udhëheqë dokumentacion të rregullt, i njofton institucionet kompetente dhe nga këshillimoret ka rezultate të mira.

- Numri më I madhë I nxënësve janë të rregullt në mësim.

Anët e dobta

- Rezultatet jo të kënaqshme të nxënësve në testimet eksterne (TIMSS,PIRLS,testime shtetërore QPSH)
- Realizimi i mësimit shtues dhe plotësuese
- Një numër i vogël i mësimdhënësve përdorin metoda, teknika, strategji në mësimin për përmirësimin e arritjeve të nxënësve.
- Shkolla i dallon nxënësit e talentuar, nxënësit që kanë vështirës në nxënien, si dhe nxënësit me pengesa në zhvillimin, por nuk e ndjekë me rregullt përparimin e tyre.

Prioritete

- Identifikimi dhe dhënia e mbështetjes për nxënësit e talentuar,nxënësit që kanë vështirsi në nxënie dhe nxënësit me NVA
- Nxitja e mësimdhënësve për përdorimin e metodave të reja mësimore,mësim interaktiv,puna në grupe etj…
- Krijimi I kushteve për realizimin e mësimit shtues dhe plotësues

Metodat që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave dhe informacionet e përpunuara

Anketa me mësimdhënësit

Pyetsor për mësimdhënësit – arritjet e nxënësve

22 mësimdhënës të anketuar

1.Arrij të identifikoj nxënësit me vështirsi në nxënie?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 19 | 86.36% |
| JO | 3 | 13.64% |

2.Arrij të identifikoj nxënësit e talentuar?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 16 | 72.72% |
| JO | 6 | 27.28% |

3.Numër i madhë i prindërve e shfrytëzojnë mundësin të kontaktojnë me mua për arritjet e fëmijëve të tyre në lëndën time?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 12 | 54.54% |
| JO | 10 | 45.46% |

4.Prindërve ju jap udhëzime të qarta se si mund të iu ndihmojnë fëmijëve të tyre në mësime?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 8 | 36.36% |
| JO | 14 | 63.64% |

Anketa për nxënësit

Pyetsor për nxënësit – arritjet e nxënësve

75 nxënës të anketuar

1.Prindërit e mi janë vazhdimisht të informuar për përparimin tim në mësime?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 57 | 76% |
| JO | 18 | 24% |

2.Mësimdhënësit gjithmonë më nxisin për përmirsimin e suksesit tim?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 64 | 85.33% |
| JO | 11 | 14.67% |

3.Nëse nuk arrijë ta përvetësoj materialin mësimor,me kërkesën time mësimdhënësit më organizojn mësim plotësues?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 23 | 30.66% |
| JO | 52 | 69.34% |

4.Nëse nuk arrijë ta përvetësoj materialin mësimor,mësimdhënësit mundohen të më spjegojnë në mënyra të ndryshme?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 37 | 49.33% |
| JO | 38 | 50.67% |

5.Nëse në ndonjë lëndë dua të mësoj më tepër nga ajo që mësojmë në orë,mësimdhënësit më ofrojnë mësim shtues?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 25 | 33.33% |
| JO | 50 | 66.67% |

Anketa për prindërit

Pyetsor për prindërit – arritjet e nxënësve

45 prindër të anketuar

1.Nga shkolla marrë këshilla të mira për përmirsimin e suksesit të fëmijut tim?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 32 | 71.11% |
| JO | 13 | 28.89% |

2.Nga shkolla marrë këshilla të mira për përmirsimin e sjelljes të fëmijut tim?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 35 | 77.77% |
| JO | 10 | 22.22% |

3.Në kontuinitet jam i informuar për rregullshmërin e fëmijut tim?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 38 | 84.44% |
| JO | 7 | 15.56% |

| 4.Fëmijut tim në shkollë i mundësohet realizimi i mësimit shtues dhe plotësues nëse ka nevojë? | | |
|---|---|---|
| PO | 13 | 28.88% |
| JO | 32 | 71.12% |

## Intervist me drejtorin dhe shërbimin profesional

### Sfera 2 – arritjet e nxënësve

1.A analizon shkolla të dhënat për arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimit, nga të gjitha lëndët mësimore, për të gjitha periudhat e kualifikimit?

Po

a.Çfarë tregojnë rezultatet?

Të dhënat tregojnë numrin e meshkujve dhe femrave të të gjitha klasave dhe paraleleve,të arriturat e nxënësve në çdo lëndë mësimore, numrin e notave negative për nxënës,si dhe në cilat lëndë kanë nota negative.Të dhënat janë për çdo periudhë të kualifikimit.

b.Si vepronі pas përpunimit të të dhënave? Çfarë ndërmerni për përmirsimin e rezultateve? (shemb. Sukses të ulët në lëndë të caktuara)

Pas raportit të këshillit arsimor të cilët mbahen në çdo 3 mujor,nëse ka sukses të ulët të nxënësve thiren në këshillimore prindërit e nxënësit, këshillohen nxënësit nga ana e psikologut dhe pedagogut,zhvillohen biseda me kujdestarët e klasave.

2.Nëse shkolla ka qenë e përfshirë në testime shtetërore/ndërkombëtare sa jeni të kënaqur me rezultatet? Nëse rezultatet kanë qenë jo të mira çfarë planifikoni të ndërmerni?

Shkolla ka qenë e përfshirë në testime shtetërore dhe ndërkombëtare dhe rezultatet nuk kanë qenë të mira.Nuk kemi marrë hapa konkret për përmirsimin e rezultateve përveq bisedave informative.

3.Cilat janë procedurat për identifikimin e nxënësve me vështirsi në nxënie,nxënësve të talentuar dhe nxënësve me NVA? Çfarë mbështetje marrin nxënësit për përmirsimin e suksesit?

Varësisht se me çfarë probleme përballen nxënësit në procesin e nxënies,shërbimi profesional nëpërmjet bisedave direkte me nxënsit dhe prindërit zbulon se çfarë probleme kanë nxënësit,qoft probleme me koncentrimin,perceptimin,motorikën,marëdhënie sociale dhe emocionale, funksionimi kognitiv etj.

Shërbimi profesional përmes mbështetjes individuale iu ndihmojnë nxënësve:
-të zhvillojnë percepcionin hapsinor vizuel
–të mbajnë koncentrimin për një kohë më të gjatë
-të zhvillojnë grafomotorikën fine dhe aftësin për shkrim
-të zhvillojnë dhe pasurojnë fjalorin
- të zvogëlojnë frustrimin dhe ngarkesën emocionale

4.Sa jeni të kënaqur me rregulshmërin e nxënësve? Çfar masa ndërmeren për nxënësit të cilët nuk janë të rregullt?

Numri më i madh i nxënësve janë të rregullt në orët mësimore,ndërsa për nxënësit që mungojnë ndjeken procedurat e parapara me ligjin për arsim fillor,si masa pedagogjike,këshillime të nxënësve dhe prindërve dhe nëse është e nevojshme bashkëpunojmë me qendrat sociale,MPB bashkësin lokale etj.

5.Si realizohen këshillimoret me prindërit dhe nxënësit? Si i vlersoni efektet e këshillimoreve ndaj përmirsimit të rregullshmëris,suksesit dhe sjelljes?

Këshillimoret realizohen pas çdo 3 mujori dhe mbajtjes së këshillit arsimor.Prindërit dhe nxënësit këshillohen nëse:
-nxënësi ka më tepër se tre nota të dobta
-ka më tepër se 10 mungesa të paarsyeshme apo 100 mungesa të arsyeshme
-nëse nxënësi ka sjellje të pahijëshme
Prindërve ju dërgohen ftesa 8 ditë para se të mbahen këshillimoret,mbahen evidenca dhe përpunohen raporte për mbajtjen e këshillimoreve.
Praktika e deritanishme flasin se nga këto këshillimore ka efekte pozitive.

Sfera 3: Klimë shkollore

| Indikatorë | Tema | Përshkruesit |
|---|---|---|
| Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollën | • Reputacion /imazh i shkollës | **Shumë mirë**<br><br>Shkolla dallohet në mjedisin lokal si shkollë që promovon arritje të larta, rregullsi, disiplinë të nxënësve dhe bashkëpunim me bashkësinë lokale. Shkolla zbaton aktivitete jashtëshkollore sipas të cilave dallohet në mjedisin. Shkolla, për afirmimin e aktiviteteve jashtëshkollore, i përdorë në mënyrë përkatëse mediat e ndryshme (p.sh. gazeta shkollore, radioja shkollore, faqja e internetit, rrjete sociale, këndi i nxënësve, etj.).<br><br>Shkolla ka ndërtuar sistem të promovimit të arritjeve të të gjithë nxënësve në kuadër të shkollës dhe në mjedisin më të gjerë lokal. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Kodi i sjelljes | **Pjesërisht kënaq**<br><br>Shkolla ka kodeks të sjelljes, në të cilën janë vendosur parimet dhe rregullat e sjelljes në shkollë të të gjitha strukturave. Në përpilimin e kodit kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjithë interesuarve për jetën në shkollë. Shkolla ka procedura të shkruara për veprim në rast të shkeljes së parimeve dhe rregullave të sjelljes, por nuk ka shembuj nga zbatimi në praktikë. Shkolla nuk praktikon përditësimin e përmbajtjes së kodit të sjelljes. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Klima shkollore | **Shumë mirë**<br><br>Në mesin e të gjithë pjesëmarrësve në jetën shkollore ekziston respekti i ndërsjellë dhe përfshirja në aktivitetet në shkollë. Në shkollë ekziston bashkëpunim profesional ndërmjet të punësuarve. Kuadri udhëheqës, mësimdhënës dhe të punësuarit tjerë kontribuojnë për mirëmbajtjen e atmosferës pozitive në shkollë. Të punësuarit i udhëzojnë nxënësit që të kujdesen për njëri-tjetrin dhe për shkollën. Të gjithë nxënësit ndjehen të sigurt dhe të pranuar nga të rriturit dhe nga nxënësit tjerë në shkollë. Në shkollë nuk ka kërcënime, gjuhë të urrejtjes, provokime, ofendime dhe/ose grafitë me porosi negative. Mjedisi për nxënie i motivon nxënësit që të vendosin qëllime më të larta. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Sjellje dhe disiplinë në shkollë | **Shumë mirë**<br><br>Shkolla ka rend shtëpiak, që e respektojnë nxënësit dhe të punësuarit. Ka atmosferë pune gjatë mësimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore. Të punësuarit kujdesen vazhdimisht për sjelljen e nxënësve gjatë pushimeve, pranimit të nxënësve dhe largimin e tyre nga shkolla, në përputhje me programin e zgjeruar të shkollës.<br><br>Shkolla e zbaton rregulloren për shqiptimin e masave pedagogjike dhe ekipi për mbështetje punon për tejkalimin e problemit për shkak të cilit është shqiptuar masa pedagogjike. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Pjesëmarrje e nxënësve në vendimmarrje dhe zgjidhje të problemeve | **Pjesërisht kënaq**<br>Në shkollë është formuar Parlamenti i nxënësve. Një pjesë e vogël e nxënësve janë të informuar nga përfaqësuesi i Parlamentit të nxënësve për gjërat që janë në interesin e tyre dhe nuk kanë mundësi të marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve dhe miratimin e konkluzioneve. Parlamenti i nxënësve propozon dhe zbaton aktivitete për përmirësimin e punës së shkollës. Ekzistojnë deri dy iniciativa të realizuara të Parlamentit të nxënësve. Nxënësit anëtarë të parlamentit të nxënësve ftohen dhe marrin pjesë në raste të rralla në mbledhjet e këshillit shkollor. |
| **Dokumente**<br>Rregullore për shqiptimin e masave pedagogjike | | |
| **Burimet e të dhënave**<br>Kodeksi i sjelljes; anketa/intervista me mësimdhënësit, prindërit dhe me nxënësit; evidencë pedagogjike për masa të shqiptuara pedagogjike; statuti i shkollës; rendi shtëpiak i shkollës; lëvdata, çmime, mirënjohje etj.; artikuj për shkollën në media kombëtare dhe lokale dhe në rrjete sociale; aktvendim për formimin e parlamentit të nxënësve dhe zgjedhjen e avokatit të nxënësve; programi dhe rregullorja për punën e parlamentit të nxënësve dhe avokatit të nxënësve; dosje e parlamentit të nxënësve (programi për punë, procesverbale, vendime, raporte nga iniciativat e realizuara të nxënësve) | | |

| | | |
|---|---|---|
| Barazi dhe drejtësi | • Njohje dhe respektim i të drejtave të fëmijëve | **Pjesërisht kënaq**<br><br>Në shkollë është zgjedhur avokati i nxënësve, por nuk ka aktivitete të realizuara për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të nxënësve. Një numër i vogël i të punësuarve në shkollë nuk i respektojnë të drejtat e fëmijëve. Shkolla ndërmerr aktivitete për t'i njoftuar prindërit me të drejtat e fëmijëve. Një numër i vogël i nxënësve konsiderojnë se të drejtat e tyre nuk respektohen. |
| | • Trajtim i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve | **Shumë mirë**<br><br>Shkolla promovon trajtim të barabartë dhe të drejtë ndaj të gjithë nxënësve. Nxënësit dinë të dallojnë trajtimin e pabarabartë dhe ku të drejtohen.<br><br>Shkolla reagon me kohë dhe në mënyrë përkatëse ndaj ankesave nga nxënësit për trajtim të pabarabartë. Të gjithë nxënësit kanë qasje dhe janë të përfshirë në aktivitetet shkollore. |

**Burimet e të dhënave**

Anketa dhe bisedime me nxënës, prindër, mësimdhënës, shërbimi profesional, raporte nga aktivitetet e zbatuara për njoftim me të drejtat e fëmijëve; procesverbale nga aktivitetet e parlamentit të nxënësve dhe avokatit të nxënësve (p.sh. numri i parashtresave dhe mënyra e zgjidhjes); struktura e paraleleve; procesverbale nga puna e EISH-së – Ekipi për Integrim Shkollor; ditari për punën e bashkëpunëtorëve profesionalë; plani operativ për orë mësimore; procesverbale nga këshilli i mësimdhënësve; kritere dhe procedura për përzgjedhjen e nxënësit të gjeneratës.

| | | |
|---|---|---|
| Raporti i partneriteti me bashkësinë | • Bashkëpunim i shkollës me prindërit/kujdestarët | **Pjesërisht kënaq**<br>Informacionet që kanë të bëjnë me punën e shkollës nuk janë të mjaftueshëm të detajuara dhe/ose mjaft të qarta për prindërit. Shkolla e pranon mbështetjen nga prindërit të cilët me vetiniciativë duan të përfshihen në jetën dhe punën e shkollës, por është i vogël numri i aktiviteteve që shkolla i ndërmerr për përfshirjen e prindërve. Nuk ka praktikë që prindërit të japin ide për përmirësimin e procesit edukativo-arsimor në shkollë. Mendimet dhe qëndrimet e prindërve/kujdestarëve në raste të rralla ndikojnë në vendime të caktuara që kanë të bëjnë me shkollën. |
| Kujdes të përgjithshëm për nxënësit | • Bashkëpunimi me komunën dhe bashkësinë urbane | **Pjesërisht kënaq**<br>Shkolla realizon bashkëpunim me komunën dhe bashkësinë urbane vetëm në kuadër të detyrimeve formale ligjore dhe ekzistojnë një numër i vogël i shembujve të projekteve dhe ngjarjeve të përbashkëta. |

<table>
<tr><td rowspan="3"></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e të dhënave<br><br>Raport për punën e shkollës (gjysmëvjetor, vjetor); procesverbale nga këshilli i prindërve dhe mbledhjet prindërore; anketa dhe intervista me drejtorin, prindërit, mësimdhënësit dhe me bashkëpunëtorët profesionalë; anketë/intervistë me përfaqësues të bashkësisë lokale; statuti i shkollës; faqja e internetit e shkollës; marrëveshje dhe memorandume për bashkëpunim me komunën dhe organizata/institucione të ndryshme; raport nga aksionet e organizuara, tribuna, debate, ligjërata me prindërit dhe me përfaqësuesit e bashkësisë lokale; dokumentacion për sponsorizime dhe donacione të pranuara</td></tr>
<tr><td>• Parandalim nga dhuna</td><td>Pjesërisht kënaq<br><br>Shkolla nuk ka protokoll në të cilin janë të përkufizuara të gjitha format e dhunës dhe mënyrat e veprimit. Të punësuarit e dinë rolin dhe përgjegjësinë e tyre në procesin e mbrojtjes së fëmijës. Shkolla mban evidencë për format e shfaqura të dhunës. Fëmijët viktima të dhunës, prindërit e tyre dhe/ose dëshmitarët e dhunës nuk janë të njoftuar nga shkolla me të drejtat dhe procedurat për parashtrimin e ankesave, e në rast të ankesës, shkolla vepron.<br><br>Shkolla nuk ka procedura për funksionim konstruktiv me të gjithë nxënësit që janë pjesë e dhunës moshatare dhe prindërit e tyre.<br><br>Aktivitetet e ndërmarra kontribuojnë në uljen e dhunës në shkollë.<br><br>Në ndërtesën e shkollës ekziston plan evakuimi</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| | • Mbrojtja nga pirja e duhanit, alkoolit dhe nga droga | **Shumë mirë**<br><br>Në godinën shkollore, në vende të dukshme, janë vendosur shenja për ndalimin e pirjes së duhanit, futjes dhe konsumit të alkoolit, shpërndarjes dhe konsumit të substancave narkotike. Në shkollën realizohen një numër i madh i aktiviteteve për mbrojtje nga ndikimet e dëmshme të pirjes së duhanit, alkoolit dhe mjeteve narkotike. |
| | | |

| | | |
|---|---|---|
| | • Kualiteta e ushqimit në dispozicion | **Pjesërisht kënaq**<br><br>Shkolla kujdeset për kualitetnë e ushqimit që u është ofruar nxënësve në shkollë. Në shkollë nuk zhvillohet sferatë për të ushqyerit e shëndoshë. |
| | | |

| | | |
|---|---|---|
| Kujdes të përgjithshëm për nxënësit | • Higjienë dhe mbrojtje nga sëmundjet | **Pjesërisht kënaq**<br><br>Tualetet janë të pastra në çdo kohë të ditës. Shkollat një herë në vit nuk bën dezinfektim, dezinsektim dhe deratizim. Korridoret, shkallët, dyshemeja dhe hapësira tjetër e shkollës pastrohen së paku një herë gjatë ditës, mobiliet një herë në javë, ndërsa dritaret, dyert dhe inventari tjetër së paku një herë në çdo gjysmëvjetor. Oborri i shkollës është i pastër, por nuk është i rregulluar sa duhet në aspektin hortikulturor. Në shkollë ka shporta të pamjaftueshme për mbeturina. Në rast të shfaqjes së sëmundjes ngjitëse, shkolla miraton procedurë të dakorduar për mbrojtje nga përhapja e saj. Të gjithë të punësuarit dhe nxënësit rregullisht bëjnë kontrolle sistematike. Në shkollë nuk ka persona të trajnuar për të dhënë ndihmën e parë. |

| | | |
|---|---|---|
| | Kujdes për sigurinë e nxënësve dhe të punësuarve | **Pjesërisht kënaq**<br>Në shkollën ka aparate zjarrfikëse që nuk servisohen rregullisht. Hidrantët janë funksionalë. Nuk ka dokument për matjen e kryer të instalimit të rrufepritësit. Në godinën shkollore ekziston plan për evakuim që është vendosur në vend të dukshëm, por vitin e fundit nuk është bërë simulimi për braktisjen e shpejtë të ndërtesës në rast të fatkeqësive elementare dhe rrezikut tjetër. |
| | • Kujdesi për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale | **Pjesërisht kënaq**<br>Shkolla i identifikon, por nuk siguron mjete materiale për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale. Shkolla bashkëpunon jorregullisht me faktorët e ndryshëm nga bashkësia për ndihmë dhe mbështetje të nxënësve nga familjet e rrezikuara sociale. |
| | • Kujdes për nxënësit me probleme shëndetësore | **Pjesërisht kënaq**<br>Shkolla kohë pas kohë siguron realizimin e mësimit për nxënësit që për shkak të arsyeve shëndetësore një kohë të gjatë mungojnë nga mësimi i rregullt. Me këtë rast nuk ka bashkëpunim me bashkësinë lokale dhe/ose institucione të tjera relevante (institucione shëndetësore, qendra për punë sociale). |

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| | • Kujdesi për mirëqenien socio-emocionale të nxënësve | **Pjesërisht kënaq**<br>Shërbimi profesional në shkollë reagon në raste të vështirësive socio-emocionale te nxënësit. Bashkëpunëtorët profesional nuk janë të trajnuar mjaftueshëm që t'u ndihmojnë nxënësve me vështirësi emocionale dhe prindërve të tyre ose t'i udhëzojnë te institucionet relevante (qendra këshillimore, qendra për punë sociale, polici, shoqata qytetare, etj).<br>Në shkollë nuk zbatohen aktivitete për nxënie socio-emocionale. |
| | • Dhënia e ndihmës gjatë përzgjedhjes për vazhdimin e arsimit | **Shumë mirë**<br>Shkolla me kohë u siguron nxënësve informacione të qarta dhe të sakta për mundësitë për vazhdimin e arsimit. Për këtë qëllim organizon aktivitete personale dhe përdorë materiale promovuese nga institucionet arsimore për orientimin profesional të nxënësve.<br>Shkolla i informon rregullisht prindërit dhe nxënësit për ndihmën që mund ta marrin përmes kumtesave me shkrim dhe me gojë.<br>Shkolla u jep ndihmë nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve të tyre në zgjedhjen e shkollës së mesme. |

| | | |
|---|---|---|
| | | |

**Dokumente**

Udhëzues për procedurën për denoncim dhe mbrojtje të nxënësit viktimë të çfarëdo forme të dhunës, keqpërdorimit dhe mospërfilljes

Rregullore për regjistrimin e fëmijëve të cilët nuk janë të përfshirë në mësimin, ndërsa janë me kufi të kaluar të moshës

Programi për orientim profesional për nxënësit e klasës së tetë dhe të nëntë

Udhëzues për mirëmbajtjen e objekteve shkollore

Rregullore për standardet për të ushqyerit dhe racionet në shkollë fillore

**Burimet e të dhënave**

Kodi i sjelljes; rendi shtëpiak i shkollës; mbikëqyrja e kushteve në shkollë; protokoll për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna; anketa/intervista me mësimdhënësit, prindërit dhe me nxënësit; evidenca pedagogjike për masa të shqiptuara pedagogjike; procesverbalet nga këshillimet; raporti për punën e shkollës (gjysmëvjetor, vjetor); procesverbale nga këshilli i prindërve dhe mbledhjet prindërore; anketa dhe intervista me drejtorin, prindërit, mësimdhënësit dhe me bashkëpunëtorët profesionalë; evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni; tribunat e organizuara, debate, ligjërata me nxënësit, prindërit dhe me përfaqësuesit e bashkësisë lokale për tema të lidhura me: shëndetin mental, shkathtësi socio- emocionale, jetesë e shëndetshme, etj.; procesverbale nga aktivitetet e zbatuara për orientim profesional.

Sfera 3 : Klimë shkollore

Pjesërisht kënaq

| Përshkrimi/përmbledhje e sferës(fushës) |
| --- |
| Shkolla dallohet në mjedisin lokal si shkollë që promovon arritje të larta, rregullsi, disiplinë të nxënësve dhe bashkëpunim me bashkësinë lokale. Shkolla zbaton aktivitete jashtëshkollore sipas të cilave dallohet në mjedisin.Vizita e Parlamentit të Republikës,Bankës Popullore,Panairit të librit,organizimi I Tregut të shkollës dhe aktivitete tjera jashtëshkollore organizohen për çdo vit kalendarik. Shkolla, për afirmimin e aktiviteteve jashtëshkollore, i përdorë në mënyrë përkatëse mediat e ndryshme (p.sh.faqja e internetit, rrjete sociale etj.). Shkolla ka kodeks të sjelljes, në të cilën janë vendosur parimet dhe rregullat e sjelljes në shkollë të të gjitha strukturave. Në përpilimin e kodit kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjithë interesuarve për jetën në shkollë. Shkolla ka procedura të shkruara për veprim në rast të shkeljes së parimeve dhe rregullave të sjelljes, por nuk ka shembuj nga zbatimi në praktikë. Shkolla nuk praktikon përditësimin e përmbajtjes së kodit të sjelljes.<br>Në shkollë ekziston bashkëpunim profesional ndërmjet të punësuarve. Kuadri udhëheqës, mësimdhënës dhe të punësuarit tjerë kontribuojnë për mirëmbajtjen e atmosferës pozitive në shkollë. Të punësuarit i udhëzojnë nxënësit që të kujdesen për njëri-tjetrin dhe për shkollën. Të gjithë nxënësit ndjehen të sigurt dhe të pranuar nga të rriturit dhe nga nxënësit tjerë në shkollë. Në shkollë nuk ka kërcënime, gjuhë të urrejtjes, provokime, ofendime dhe/ose grafitë me porosi negative.Shkolla ka rend shtëpiak, që e respektojnë nxënësit dhe të punësuarit.Të punësuarit kujdesen vazhdimisht për sjelljen e nxënësve gjatë pushimeve, pranimit të nxënësve dhe largimin e tyre nga shkolla, në përputhje me programin e zgjeruar të shkollës. Në shkollë është formuar Parlamenti i nxënësve. Në shkollë është zgjedhur avokati i nxënësve, por nuk ka aktivitete të realizuara për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të nxënësve. Një numër i vogël i të punësuarve në shkollë nuk i respektojnë të drejtat e fëmijëve. Shkolla promovon trajtim të barabartë dhe të drejtë ndaj të gjithë nxënësve. Nxënësit dinë të dallojnë trajtimin e pabarabartë dhe ku të drejtohen.<br>Të punësuarit e dinë rolin dhe përgjegjësinë e tyre në procesin e mbrojtjes së fëmijës.Shkolla mban evidencë për format e shfaqura të dhunës. Në godinën shkollore, në vende të dukshme, janë vendosur shenja për ndalimin e pirjes së duhanit, futjes dhe konsumit të alkoolit, shpërndarjes dhe konsumit të substancave narkotike.<br>Tualetet janë të pastra në çdo kohë të ditës. Shkollat një herë në vit nuk bën dezinfektim, dezinsektim dhe deratizim. Korridoret, shkallët, dyshemeja dhe hapësira tjetër e shkollës pastrohen së paku një herë gjatë ditës, mobiliet një herë në javë, ndërsa dritaret, dyert dhe inventari tjetër së paku një herë në çdo gjysmëvjetor. Oborri i shkollës është i pastër, por nuk është i rregulluar sa duhet në aspektin hortikulturor. Në shkollën ka aparate zjarrfikëse që nuk servisohen rregullisht. Shkolla i identifikon, por nuk siguron mjete materiale për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale. Shkolla bashkëpunon jorregullisht me faktorët e ndryshëm nga bashkësia për ndihmë dhe mbështetje të nxënësve nga familjet e rrezikuara sociale. Shërbimi profesional në shkollë reagon në raste të vështirësive socio-emocionale te nxënësit. Bashkëpunëtorët profesional nuk janë të trajnuar mjaftueshëm që t'u ndihmojnë nxënësve me vështirësi emocionale dhe prindërve të tyre ose t'i udhëzojnë te institucionet relevante (qendra këshillimore, qendra për punë sociale, polici, shoqata qytetare, etj). Shkolla me kohë u siguron nxënësve |

informacione të qarta dhe të sakta për mundësitë për vazhdimin e arsimit. Për këtë qëllim organizon aktivitete personale dhe përdorë materiale promovuese nga institucionet arsimore për orientimin profesional të nxënësve.

Anët e forta

- Shkolla ka klimë pozitive
- Shkolla ka kodeks të sjelljes,rend shtëpiak me të cilat janë të njoftuar të gjithë nxënësit,mësimdhënësit,prindërit dhe të gjithë faktorët relevant.
- Shkolla ka Parlament dhe avokat të nxënësve.
- Shkolla promovon trajtim të barabart dhe të drejtë ndaj të gjithë nxënësve.
- Shkolla organizon puntori dhe aktivitete për parandalimin e dukurive negative si bullizmi,dhuna,pirja e duhanit,alkoolit,narkotikëve etj.
- Shkolla kujdeset për shëndetin mendor dhe fizik për të gjithë të punsuarit dhe nxënësit nëpërmjet kontrolleve sistematike.

Anët e dobta

- Higjiena e përgjithshme në shkollë
- Munges e personelit të trajnuar për dhënie të ndihmës së parë
- Trajnime për evakuime në rast të katastrofave natyrore
- Mos përfshirja e nxënësve në vendim marrje

Prioritete

- Përmirsimi i higjienës në shkollë
- Trajnimi i të punsuarve për dhënie të ndihmës së parë
- Mbajtja e trajnimeve nga organet kompetente për evakuim në rast të reziqeve
- Aktivizimi më të madh të parlamentit të nxënësve dhe avokatit të nxënësve në jetën shkollore.
- Të miratohet protokol për parandalimin e të gjitha formave të dhunës dhe mënyrat e veprimit.

Metodat që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave dhe informacionet e përpunuara

Anketa me prindërit

Pyetsor për prindërit – klimë shkollore

75 prindër të anketuar

1.Jam i njoftuar me kodeksin e sjelljes në shkollë?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 63 | 84% |
| JO | 12 | 16% |

2.Fëmiju im është i pranuar dhe i respektuar nga mësimdhënësit dhe nxënësit?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 68 | 90.66% |
| JO | 7 | 9.34% |

3.Fëmiju im dëshiron të shkojë në shkollë?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 72 | 96% |
| JO | 3 | 4% |

4.Fëmiju im nuk ka qenë i diskriminuar në shkollë?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 67 | 89.33% |

| | | |
|---|---|---|
| JO | 8 | 10.67% |

5.Fëmiju im është i vlersuar me kriteriume të njejta si nxënësit tjerë?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 59 | 78.66% |
| JO | 16 | 21.34% |

6.Shkolla reagon me kohë për sjelljet jo të hijëshme të nxënësve duke na njoftuar neve?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 65 | 86.66% |
| JO | 10 | 13.37% |

7.Shkolla kujdeset për gjendjen emocionale të fëmijut tim?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 54 | 72% |
| JO | 21 | 28% |

8.Higjiena në shkollë është në nivel të lartë?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 48 | 64% |
| JO | 27 | 36% |

9.Shkolla ballafaqohet mirë kur paraqiten raste dhune ?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 61 | 81.33% |
| JO | 14 | 18.67% |

Anketa me mësimdhënësit

Pyetësor për mësimdhënësit – klimë shkollore

28 mësimdhënës të anketuar

1.Shkolla reagon në mënyrë adekuate nëse thyhet kodeksi i sjelljes?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 23 | 82.14% |
| JO | 5 | 17.86% |

2.Atmosfera në shkollë është pozitive dhe inkurajuese ?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 19 | 67.86% |
| JO | 9 | 32.14% |

3.Gjatë orëve të mija kam atmosferë të mirë pune?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 22 | 78.57% |
| JO | 6 | 21.43% |

4.Kam bashkpunim të mirë me kolegët e punës në shkollë?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 24 | 85.71% |
| JO | 4 | 14.29% |

5. Reagoj në mënyrë adekuate ndaj ankesave të nxënësve për trajtim jo të barabart?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 19 | 67.86% |
| JO | 9 | 32.14% |

6.Prindërit dhe nxënësit marrin informacione përkatëse për kodeksin e sjelljes në shkollë?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 21 | 75% |
| JO | 7 | 25% |

7.I pranoj idetë e argumentuara të prindërve për përmirsimin e klimës shkollore?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 23 | 82.14% |
| JO | 5 | 17.86% |

8.Me nxënësit diskutojmë mbi sjelljet devijante dhe eliminimin e tyre?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 24 | 85.71% |
| JO | 4 | 14.29% |

Anketë me nxënësit

Pyetësor për nxënësit – klimë shkollore

85 nxënës të anketuar

1.Në shkollë ndjehem i/e sigurt ?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 72 | 84.70% |
| JO | 13 | 15.30% |

2.Në shkollë ndjehem i/e pranuar nga mësimdhënësit dhe nxënësit?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 63 | 74.12% |
| JO | 22 | 25.88% |

3.Dua të shkoj në shkollë?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 77 | 90.59% |
| JO | 8 | 9.41% |

4.Mësimdhënësit i kuptojnë nevojat dhe problemet e mija?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 54 | 63.53% |
| JO | 31 | 36.47% |

5.Rregullat e shkollës implementohen njejtë për të gjithë nxënësit?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 65 | 76.47% |
| JO | 20 | 23.53% |

6.Jam i njoftuar me pasojat në rast të sjelljeve jo të hijëshme?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 51 | 60 % |
| JO | 34 | 40 % |

7.Kemi mundësi të barabarta për pjesmarrje në aktivitetet shkollore?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 58 | 68.24% |
| JO | 27 | 31.76% |

8.Kur kam nevojë,mundem lirisht të kërkoj këshilla dhe mbështetje tek psikologu dhe pedagogu i shkollës?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 64 | 75.29% |
| JO | 21 | 24.71% |

9.Në shkollë punojmë mbi zgjidhjen e konflikteve dhe ballafaqimi me situata të dhunshme?

| | | |
|---|---|---|
| PO | 48 | 56.47% |
| JO | 37 | 43.53% |

| | | |
|---|---|---|
| 10.Shkolla është e pastër dhe e rregulluar? | | |
| PO | 42 | 49.41% |
| JO | 43 | 50.59% |

Rezultate nga analiza e dokumenteve

Protokol për analiz të dokumenteve

Protokoli për analizë të dokumenteve na duhet për të parë se këto dokumente i posedon apo jo shkolla pa ndërhyrë në përmbajtjen e tyre.

| **Dokumente** | **Po** | **Jo** |
|---|---|---|
| Kodeksi i sjelljes | + | |
| Evidenc për masa pedagogjike | | - |
| Statuti i shkollës | + | |
| Rrendi shtëpiak i shkollës | + | |
| Lëvdata,mirënjohje,çmime etj.. | + | |
| Vendim për formimin e Parlamentit dhe avokatit të nxënësve | + | |
| Udhëzues dhe program për punën e Parlamentit dhe avokatit të nxënësve | + | |

| | | |
|---|---|---|
| Dosje të Parlamentit të nxënësve (programa për punë,procesverbale,vendime,raporte për iniciativa të nxënësve) | + | |
| **Dokumente** | **Po** | **Jo** |
| Raporte për aktivitete të kryera për njohjen e të drejtave të fëmijëve | | - |
| Procesverbale për aktivitete të Parlamentit të nxënësve dhe akokatit të nxënësve | + | |
| Struktura e paraleleve | + | |
| Procesverbale nga puna e EIN – ekipit për integrim ndëretnik | + | |
| Ditar për punën e shërbimit profesional | + | |
| Plani operativ për orë mësimore | + | |
| Procesverbale nga këshilli arsimor | + | |
| Kriteriume për përzgjedhjen e nxënësit të gjeneratës | | - |
| **Dokumetne** | **Po** | **Jo** |
| Raport të punës së shkollës (gjysëmvjetor,fundvit) | + | |
| Procesverbale të mbledhjeve të këshillit të prindërve dhe takimeve të prindërve | | - |
| Statuti i shkollës,webfaqja e shkollës | + | |
| Marëveshje dhe memorandume bashkpunimi me komunën dhe organizata tjera | | - |
| Dokumente për donacione,sponzorizime etj | + | |
| **Dokumente** | **Po** | **Jo** |

| | | |
|---|---|---|
| Protokol për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna | | - |
| Procesverbale për aktivitete të ndërmarra për orientim profesional | + | |
| Procesverbale nga këshillimoret | + | |
| Organizime të tribunave,debateve,ligjerata me nxënësit mbi shëndetin mendor,shkathtësi socio-emocionale,të jetuarit e shëndetshëm etj | + | |

Intervist me drejtorin dhe shërbimin profesional

Sfera 3 – klimë shkollore

1.Me çka është e njohur shkolla juaj në bashkësin lokale?

Shkolla është e njohur me kualitetin e punës,të arriturat e nxënësve në fusha të ndryshme.Të punsuarit në shkollë gjithmonë kërkojnë të përmirsohen në apektin profesional bashkëpunues që është një parakusht themelor për atmosferën e mirë të punës në shkollë.Kodeksi i sjelljes respektohet nga të gjithë nxënësit dhe të punsuarit dhe kjo bënë që në shkollën tonë të kemi shumë pak raste ku paraqitet sjellje delikuente. Mësimi është i organizuar sipas standardeve pedagogjike dhe ligjeve.Mësimdhënësit me anë të metodave të reja të punës,përmes lëvdatave dhe mirënjohjeve mundohen ti stimulojnë dhe motivojnë nxënësit për arritjet dhe zhvillimin e tyre.

2.Kur dhe nga kush është miratuar kodeksi i sjelljes në shkollë?

Kodeksi i sjelljes është miratuar nga këshilli i mësimdhënësve dhe me respektimin e kodeksit të sjelljes sigurohet mbarëvajtje e procesit edukativo-arsimor në shkollë,disciplina,siguria në shkollë etj.

3.Si e vlersoni klimën e përgjithshme në shkollë?

Klimën shkollore në mes të të gjitha strukturave e cilësoj si mjaft prozitive ngase sa më i mirë dhe respektues të jetë raporti ndërmjet të të gjithëve aq më e mirë do të jetë klima shkollore dhe atmosfera e punës.Klima e shkollës është indikator për cilësin e shkollës ngase çdokush do të ndjej përgjegjësi për veprimet e tij dhe do të zhvillohet ndjenja e përkatësis.

4.Si funksionon Parlamenti i nxënësve dhe avokati i nxënësve?

Parlamenti i nxënësve funsksionon nëpërmjet mbledhje të rregullta mujore ndërsa avokati i nxënësve është i angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.Në bazë të rolit dhe kompetencave të Parlamentit të nxënësve dhe duke u bazuar ne Nenin 68 paragrafi 6 të ligjit për arsim fillor,Parlamenti i nxënësve në mënyrë aktive promovon dhe mbron të drejtat e nxnësve,organizon dhe marrin pjesë në aksione humanitare dhe aktivitete tjera shoqërore.Nëpërmjet përfaqsuesve të tyre marrin pjesë në mbledhjet e këshillit të shkollës dhe këshillit të mësimdhënësve etj.

5.Sa shpesh në shkollë mbahen puntori mbi temën e duhanit,drogës dhe alkoholit?

Në shkollë janë të vendosura sinjale vizuele për ndalimin e pirjes së duhanit dhe nga ana e shërbimit profesional për çdo vit mbahen puntori për ti njoftuar nxënësit mbi këto tema.Gjithashtu ndonjëher kemi bashkpunime me qendrën sociale për të realizuar puntori mbi këto tema.

6.A drejtohen nxënësit tek shërbimi profesional në raste kur kanë probleme?

Po,nxënësit gjithmonë gjejnë mbështetje tek shërbimi profesional të cilët sigurojnë që nxënëst të ndihen të ndëgjuar dhe të sigurt për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Sfera 4: Menaxhim, udhëheqje dhe hartim të politikave

| Indikatorë | Tema | Përshkruesit |
|---|---|---|
| Menaxhim dhe udhëheqje e shkollës | • Menaxhim i shkollës | **Shumë mirë**<br><br>Këshilli i shkollës është konstituuar në përputhje me rregullativën ligjore. Puna e këshillit shkollor është përkufizuar qartë me rregulloren për punë të këshillit të shkollës dhe është transparente. Këshilli i shkollës ka vendosur raport partneriteti me organin udhëheqës të shkollës dhe strukturat tjera shkollore.<br><br>Të gjithë anëtarët e këshillit të shkollës njoftohen me kompetencat.<br><br>Anëtarët e këshillit të shkollës i shqyrtojnë në detaje dhe miratojnë dokumentet programore të shkollës.<br><br>Këshilli i shkollës në periudhë tremujore ndjekë shpenzimin e buxhetit, me qëllim që të ketë qasje në mjetet e shpenzuara financiare. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Udhëheqja e shkollës | **Shumë mirë**<br><br>Organi udhëheqës ka vizion të qartë të shkollës me të cilin janë njoftuar të gjithë faktorët e përfshirë në jetën e shkollës. Ai punon në mënyrë ekipore gjatë procesit të ndërtimit të politikave, planifikimit dhe sigurimit të kualitetit. Risitë në arsim i implementon në nivel të shkollës. I ndjekë në vazhdimësi planet e veprimit për realizimin e programit zhvillimor. Vendosë partneritet me mjedisin e drejtpërdrejt lokal, mjedis afarist dhe organizata qytetare. Drejtori e përfshin shkollën në rrjete shkollore rajonale dhe ndërkombëtare. |
| | • Menaxhim dhe udhëheqje e resurseve | **Pjesërisht kënaq**<br><br>Në shkollë përpilohet plan dhe orar për përdorimin e kapaciteteve në dispozicion për realizimin e mësimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore. Shkolla siguron material shpenzues, me kërkesë të mësimdhënësve për realizimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëshkollore.<br><br>Biblioteka shkollore/mediateka ka në dispozicion më shumë se dy libra për nxënës, duke përfshirë edhe botimet e lektyrave, por nuk ka në të gjitha gjuhët mësimore që mësohen në shkollën. Biblioteka nuk ka sallë leximi dhe evidenca e bibliotekës udhëhiqet në përputhje me Ligjin për bibliotekat. Biblioteka është e hapur për përdorim nga nxënësit dhe mësimdhënësit sipas orarit të hartuar. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Udhëheqja e kuadrit | **Pjesërisht kënaq**<br>Shkolla ka kuadër përkatës mësimor për realizimin e planeve dhe programeve mësimore, si dhe bashkëpunëtorëve profesionalë. Në shkollë procedura për zëvendësimin e mësimdhënësve dhe plotësim të mësimit në raste të mungesës afatshkurtër dhe afatgjatë zbatohet me vështirësi.<br><br>Programi për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional nuk përpilohet në bazë të planeve të tyre personale zhvillimore. Shkolla nuk praktikon diseminacion të rregullt të trajnimeve bazike. Shkolla përfshin kuadrin mësimdhënës dhe bashkëpunëtorët profesionalë në trajnime eksterne, pa respektuar nevojat e kuadrit. Drejtori e respekton rregullativën ligjore për zhvillim profesional dhe në karrierë të kuadrit, por nuk ka mekanizma të brendshëm për dhënien e mirënjohjeve për kuadrin që përfshinë inovacione efektive në punë. Kuadri mësimdhënës dhe bashkëpunëtorët profesional nuk kanë dosje tërësisht të përditësuara profesionale.<br><br>Shkolla ka procedurë të përcaktuar për organizimin dhe realizimin e stazhit të praktikantit. |
| | | |

| | | |
|---|---|---|
| | • Ndjekje dhe avancim i procesit mësimor | **Shumë mirë**<br><br>Drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë, pas orarit të përpiluar paraprakisht, e ndjekin në mënyrë të vazhdueshme punën e mësimdhënësve. Secili mësimdhënës ndiqet në së paku një orë mësimore gjatë një gjysmëvjetori për çka jepet informacion kthyes. Për ndjekjen e orës mësimore drejtori dhe bashkëpunëtorët profesionalë përdorin çek- lista/protokolle të përgatitura si përgatitje për ndjekje të suksesshme të orës mësimore. |
| **Burimet e të dhënave**<br><br>Programi për punë i këshillit të shkollës; rregullore për punën e këshillit të shkollës; statuti i shkollës; procesverbalet, vendimet dhe raportet nga puna e këshillit të shkollës (vjetor, gjysmëvjetor, të veçantë); program zhvillimor i shkollës; program për punën e drejtorit; programe për zhvillim profesional; dëshmi për pjesëmarrje dhe diseminicion të trajnimeve (listave, agjendave, listave të evaluimit); intervista me mësimdhënës, prindër dhe nxënës dhe këshillin e shkollës; orar dhe procedura për përdorimin e hapësirës dhe materialeve në shkollë; pyetësor për personin përgjegjës nga komuna; dëshmi për përfshirje në rrjete rajonale dhe ndërkombëtare arsimore (aktivitete, shkresa, aplikime), aktivitete dhe program për punën e bibliotekës shkollore/mediatekë | | |

| | | |
|---|---|---|
| Qëllime dhe hartim i politikës shkollore | • Procedura për hartimin e politikës shkollore | **Shumë mirë**<br><br>Shkolla ka procedura të përcaktuara për miratimin e politikave shkollore, në të cilat janë të përfshirë të punësuarit, nxënësit, strukturat shkollore dhe faktorët tjerë. Shkolla vazhdimisht i përmirëson politikat për avancimin e kualitetit së funksionimit në shkollë. |
| | • Rezultatet nga planifikimi zhvillimor | **Pjesërisht kënaq**<br><br>Qëllimet në programin zhvillimor nuk i reflektojnë mjaftueshëm sfidat e identifikuara nga vetevaluimi dhe evaluimi integral i shkollës. Gjatë vendosjes së tyre janë përfshirë drejtori dhe një pjesë e mësimdhënësve. Shkolla i informon mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit për rezultatet që duhet të arrihen. Shkolla ka plane veprimi për arritjen e rezultateve nga qëllimet e vendosura. Shkolla ka plan për ndjekjen dhe evaluimin e programit zhvillimor, por nuk e respekton dinamikën e ndjekjes dhe evaluimit. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit shkollor | **Shumë mirë**<br><br>Drejtori i informon organet dhe trupat e shkollës për buxhetin shkollor dhe shpenzimin dhe përpilon plan financiar për shpërndarjen e mjeteve financiare. Prioritetet buxhetore janë të lidhura ngushtë me prioritetet e qëllimeve arsimore të shkollës. Buxheti përdoret me dedikim dhe për qëllime që janë të fokusuara në përmirësimin e kualitetit së mësimit dhe nxënies, përmirësimin e arritjeve të nxënësve, si dhe zhvillimin e shkollës në tërësi. Plani financiar është aprovuar nga Këshilli i shkollës dhe Këshilli i komunës. |
| **Burimet e të dhënave**<br><br>Programi zhvillimor i shkollës; programi vjetor i punës së shkollës; raporti nga vetevaluimi; plani për ndjekjen dhe evaluimin e realizimit të planeve të veprimit; anketa/intervista me drejtorin, bashkëpunëtorët profesionalë, mësimdhënësit, prindërit, nxënësit; procesverbale nga këshilli i shkollës, këshilli i prindërve, këshilli i mësimdhënësve; akte interne; programi për punë dhe raporte për punën e këshillit të shkollës; plani për zhvillim profesional; buxhet dhe plan financiar të shkollës. | | |

Sfera 4: Menaxhim, udhëheqje dhe hartim të politikave

Pjesërisht kënaq

| Përshkrimi/përmbledhje e sferës(fushës) |
| --- |
| Këshilli i shkollës është konstituuar në përputhje me rregullativën ligjore. Puna e këshillit shkollor është përkufizuar qartë me rregulloren për punë të këshillit të shkollës dhe është transparente. Këshilli i shkollës ka vendosur raport partneriteti me organin udhëheqës të shkollës dhe strukturat tjera shkollore.<br>Organi udhëheqës ka vizion të qartë të shkollës me të cilin janë njoftuar të gjithë faktorët e përfshirë në jetën e shkollës. Ai punon në mënyrë ekipore gjatë procesit të ndërtimit të politikave, planifikimit dhe sigurimit të kualitetit. Risitë në arsim i implementon në nivel të shkollës. I ndjekë në vazhdimësi planet e veprimit për realizimin e programit zhvillimor. Vendosë partneritet me mjedisin e drejtpërdrejt lokal, mjedis afarist dhe organizata qytetare.<br>Biblioteka shkollore/mediateka ka në dispozicion më shumë se dy libra për nxënës, duke përfshirë edhe botimet e lektyrave, por nuk ka në të gjitha gjuhët mësimore që mësohen në shkollën. Biblioteka nuk ka sallë leximi dhe evidenca e bibliotekës udhëhiqet në përputhje me Ligjin për bibliotekat. Biblioteka është e hapur për përdorim nga nxënësit dhe mësimdhënësit sipas orarit të hartuar. Shkolla ka kuadër përkatës mësimor për realizimin e planeve dhe programeve mësimore, si dhe bashkëpunëtorëve profesionalë. Programi për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional nuk përpilohet në bazë të planeve të tyre personale zhvillimore. Shkolla nuk praktikon diseminacion të rregullt të trajnimeve bazike. Shkolla përfshin kuadrin mësimdhënës dhe bashkëpunëtorët profesionalë në trajnime eksterne, pa respektuar nevojat e kuadrit. Shkolla ka procedurë të përcaktuar për organizimin dhe realizimin e stazhit të praktikantit.<br>Drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë, pas orarit të përpiluar paraprakisht, e ndjekin në mënyrë të vazhdueshme punën e mësimdhënësve. Secili mësimdhënës ndiqet në së paku një orë mësimore gjatë një gjysmëvjetori për çka jepet informacion kthyes. Për ndjekjen e orës mësimore drejtori dhe bashkëpunëtorët profesionalë përdorin çek- lista/protokolle të përgatitura si përgatitje për ndjekje të suksesshme të orës mësimore. Drejtori i informon organet dhe trupat e shkollës për buxhetin shkollor dhe shpenzimin dhe përpilon plan financiar për shpërndarjen e mjeteve financiare. Prioritetet buxhetore janë të lidhura ngushtë me prioritetet e qëllimeve arsimore të shkollës. Buxheti përdoret me dedikim dhe për qëllime që janë të fokusuara në përmirësimin e kualitetit së mësimit dhe nxënies, përmirësimin e arritjeve të nxënësve, si dhe zhvillimin e shkollës në tërësi. Plani financiar është aprovuar nga Këshilli i shkollës dhe Këshilli i komunës. |

Anët e forta

- Menaxhimi dhe udhëheqja e shkollës është mjaft e mire
- Është investuar në insfrastrukturë,inventarë dhe mjete ndihmëse
- Pjesa më e madhe e mësimdhënësve është i kualifikuar dhe i aftë për ti realizuar aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore në përputhje me interesat e nxënësve
- Krijimi i politikave të shkollës dhe qëllimet janë në përputhje me politikat shtetërore dhe lokale të arsimit

Anët e dobta

- Shkolla nuk ka mekanizma të brendshëm për dhënie të mirënjohjeve për mësimdhënësit
- Respektimi i nevojave të mësimdhënësve për ngritje profesionale nëpërmjet trajnimeve
- Mungesa e sallës së leximit në bibliotekë dhe mungesa e librave dhe lektyrave në bazë të rregullativës së BZHA
- Mungesa e kyçjes së shkollës në rrjetin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare
- Edhe përkundër transaprencës,shumica e nxënësve dhe prindërve nuk janë të njoftuar me menaxhimin e buxhetit të shkollës dhe marrjen e vendimeve të ndryshme

Prioritete

- Rishikimi  i rregullorës për dhënie të mirënjohjeve mësimdhënësve për arritjet e tyre
- Trajnimi i mësimdhënësve për ngritje profesionale në bazë të interesave të tyre
- Furnizimi i bibliotekës shkollore me tituj e lektyra në bazë të udhëzimeve të BZHA dhe sallës së leximit
- Aplikimi në rrjetin Erasmus dhe aktivitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare
- Gjetja e mënyrave alternative për informim të nxënësve dhe prindërve për menaxhimin e buxhetit të shkollës dhe marrjen e vendimeve të ndryshme

Metodat që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave dhe informacionet e përpunuara

Anketa me prindërit

Pyetësor për prindërit - Menaxhim, udhëheqje dhe hartim të politikave

63 prindër të anketuar

1.Shkolla më inkurajon në mënyrë aktive të marrë pjesë në aktivitetet të ndryshme të shkollës

| | | |
|---|---|---|
| PO | 38 | 60.32% |
| JO | 25 | 39.68% |

2.Këshilli i shkollës në mënyrë transaparente i shpall të gjitha vendimet e marra

| | | |
|---|---|---|
| PO | 32 | 50.80% |
| JO | 31 | 49.20% |

3.Biblioteka shkollore është në dispozicion për të gjithë nxënësit

| | | |
|---|---|---|
| PO | 43 | 68.25% |
| JO | 20 | 31.75% |

4.Kuadri arsimor i shkollës është kualitativ dhe kompetent

| | | |
|---|---|---|
| PO | 51 | 80.95% |
| JO | 12 | 19.05% |

5.Jam i njoftuar me mënyrën se si shpenzohet buxheti i shkollës

| | | |
|---|---|---|
| PO | 22 | 34.92% |
| JO | 41 | 65.08% |

Anketë me mësimdhënësit

Pyetësor për mësimdhënësit - Menaxhim, udhëheqje dhe hartim të politikave

21 mësimdhënës të anketuar

1.Jam i informuar për rezultatet që duhet të arrihen sipas programës zhvillimore të shkollës dhe dinamikën e realizimit

| | | |
|---|---|---|
| PO | 13 | 61.90% |
| JO | 8 | 38.10% |

2.Në shkollë praktikohet bashkëpunimi ndërmjet organeve udhëheqëse të shkollës,kuadrit arsimor,nxënësve dhe prindërve në marrjen e vendimeve

| | | |
|---|---|---|
| PO | 9 | 42.86% |
| JO | 12 | 57.14% |

3.Shkolla më ofron materiale për realizimin e aktivteteve mësimore dhe jashtëmësimore

| | | |
|---|---|---|
| PO | 7 | 33.33% |
| JO | 14 | 66.67% |

4.Shkolla më ofron mundësi të marrë pjesë në trajnime në bazë të interesave të mija

| | | |
|---|---|---|
| PO | 11 | 52.38% |
| JO | 10 | 47.32% |

5.Drejtori dhe shërbimi profesional së paku një herë në gjyëmvjetor ndjekin orët e mija dhe marrë këshilla konstruvktive nga ata

| | | |
|---|---|---|
| PO | 17 | 80.95% |
| JO | 4 | 19.05% |

6.Shkolla mbështet dhe jep mirënjoheje për punën kualitative të mësimdhënësve

| | | |
|---|---|---|
| PO | 6 | 28.57% |
| JO | 15 | 71.43% |

7.Jam i njoftuar me mënyrën se si shpenzohet buxheti i shkollës

| | | |
|---|---|---|
| PO | 14 | 66.67% |
| JO | 7 | 33.33% |

Anketë me nxënësit

Pyetsor për nxënësit - Menaxhim, udhëheqje dhe hartim të politikave

88 nxënës të anketuar

1.Jam i/e informuar për aktivitete e shkollës që planifikohen të realizohen

| | | |
|---|---|---|
| PO | 42 | 47.73% |
| JO | 46 | 52.27% |

2.Mund të marrë libër/lektyrë në bibliotekën e shkollës në çdo kohe

| | | |
|---|---|---|
| PO | 59 | 67.05% |
| JO | 29 | 32.95% |

3.Dua që shkolla të ketë sallë të leximit ku do të kisha lexuar dhe mësuar në një ambient të qetë

| | | |
|---|---|---|
| PO | 78 | 88.64% |
| JO | 10 | 11.36% |

Përfundimi

Në bazë të Nenit 129 të Ligjit për arsim fillor ( gazeta zyrtare e RMV me nr.161/19 dhe 229/20) SHFK Ibe Palikuqa – f.Bojanë,Saraj-Shkup realizoi procesin e vetëevaluimit të shkollës për periudhën 2022 - 2024.

Procesi i vetëevaluimit u zbatua në periudhën shtator – tetor 2024 dhe për realizimin e suksesshëm të tij Komisioni siguroi pjesëmarrje të të gjithë akterëve të involvuar në procesin edukativo-arsimor duke formuar ekipe punuesë për sferat e përfshira në vetëevaluim.

Ekipet zbatuan anketa,intervista,dokumente dhe burime të tjera për mbledhjen e informacioneve për sferat përkatëse,me çka dhanë përshkrime për të ariturat e indikatorëve në kuadër të sferave të hulumtuara.

Për çdo sferë u dha përshkrim/reyzme për anët e forta dhe të dobta si dhe propozoj prioritete në bazë të cilëve do të përpilo het Programa zhvillimore e shkollës.

Rezultatet e vetëevaluimit për periudhën 2022/2023-2023/2024 me propozim masat për përmirsimin e kualitetit të procesit edukativo-arsimor,komisioni i dorëzon tek këshilli i shkollës,drejtori dhe themeluesi gjegjësisht Komuna e Saraj-it.

Raporti do të publikohet edhe në webfaqen e shkollës dhe të komunës.

Gjithashtu,raportin me rezultatet e vetëevaluimit shkolla i dërgon në formë elektronike tek Qendra e provimeve shtetërore në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të procesit të vetëevaluimit.

Data 10/10/2024